



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr. 16-12260/14
Kaçanik, 30.04.2014

RREGULLORE PËR SHËRBIME PUBLIKE

Prill 2014

Në mbështetje të neneve 12.2(c), 14, 17 (f) dhe (p) dhe 40.2(a) të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), të nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut Nr 01-3588/08 të datës 30.05.2008 si dhe nenit 15.1 (a) të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30. 04.2014, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SHËRBIME PUBLIKE

Nr.	KAPITUJT	Faqe
1.	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME-----	4
2.	DEFINICIONET-----	5
3.	RRUGËT-----	6
4.	TROTUARET-----	9
5.	BARRIERAT (Policët e Shtrirë)-----	10
6.	PASTRIMI I RRUGËVE-----	12
7.	UJËSJELLËSI-----	14
8.	UJËRAT SIPËRFAQËSOR-----	16
9.	KANALIZIMI FEKAL-----	18
10.	NYJET SANITARE PUBLIKE-----	19
11.	GROPAT SEPTIKE-----	20
12.	MBETURINAT-----	21
13.	GJELBËRIMI-----	24
14.	KUSHTET MINIMALE PËR PASTËRTI NË FSHATRA-----	27
15.	GROPIMI, RRËMIHJA, PRERJA OSE SHPUARJA E SIPËRFAQEVE PUBLIKE--	28
16.	RRETHOJAT-----	29
17.	OBJEKTET PUBLIKE-----	30
18.	NDRIÇIMI PUBLIK-----	30
19.	TREGJET-----	31
20.	SHITBLERJET AMBULANTE-----	33
21.	VERANDAT-----	34
22.	FIRMAT DHE REKLAMAT-----	35
23.	VITRINAT-----	38
24.	TABELAT E SHPALLJEVE-----	39
25.	AGREGATËT-----	40
26.	NDALESAT DHE GJOBAT-----	40
27.	DISPOZITAT E FUNDIT-----	42

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi primar i kësaj rregulloreje është përmirësimi i kushteve jetësore të qytetarëve, rregulli qetësia dhe rendi komunal, pamja sa më e bukur e qytetit dhe vendbanimeve tjera, mbrojtja e ambientit jetësor si dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sa më racional i objekteve publike dhe institucionale. Me Rregulloren Komunale për Shërbimeve Publike (në tekstin e mëtejme Rregullore), synohet të përcaktohen kushtet e përgjithshme për kryerjen e veprimtarive komunale, mirëmbajtja dhe mbajtja e higjienës në hapësirat publike si dhe të caktohen detyrat dhe obligimet e qytetarëve, ekonomive familjare, bashkësive të ndryshme, shoqatave, bizneseve, ndërmarrjeve (private, publike, shtetërore), institucioneve, organeve të administrimit lokal si dhe subjekteve të tjera për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike në qytetin e Kaçanikut e në veçanti të caktohen kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë e higjienës në vendbanime periferike dhe në tërë teritorrin e Komunës së Kaçanikut.

Neni 2

2.1 Shërbime Komunale, në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a) Furnizimi i banorëve me ujë kualitativ për pije, në mënyrë të rregullt.
- b) Rregullimi dhe përcjellja e ujërave të zeza.
- c) Rregullimi dhe përcjellja e ujërave atmosferike, sipërfaqësore.
- d) Rregullimi, grumbullimi, klasifikimi, transportimi, deponimi, dhe përpunimi, i mbeturinave.
- e) Rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara publike.
- f) Pastërimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuarave, shesheve dhe sipërfaqeve publike.
- g) Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe akulli.
- h) Rregullimi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave.
- i) Ndriqimi i rrugëve dhe hapsirave publike.
- j) Funkcionimi normal i tregjeve komunale.
- k) Përkujdesja për objektet publike, varrezave dhe objekteve përkujtimore historike etj.

2.2 Mirëmbajtja e përmendoreve, shtatoreve, busteve, simboleve, varrezave dhe transporti lokal rregullohen me rregullore të veçanta.

Neni 3

Objekte komunale-publike, në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a) Objektet, rrjeti dhe pajisjet tjera të sistemit të ujësjellësit.
- b) Objektet, rrjeti dhe pajisjet tjera të sistemit të kanalizimit, atmosferik dhe fekal.
- c) Rrugët locale.
- d) Trotuaret.
- e) Hapësirat për parkingje publike.
- f) Objektet e institucioneve.
- g) Objektet publike: urat, kanalet, stacionet, të gjitha objektet e komunikacionit, objektet përkujtimore. Muzetë, objektet e kulturës dhe historisë, objektet me interes

të përgjithshëm.

- h) Parqet, sheshet, kthesat dhe hapësira të tjera rreth rrugëve.
- i) Terrenet sportive dhe ato për rekreacion.
- j) Objektet, rrjeti dhe pajisjet e ndriçimit publik.
- k) Lokacioni dhe objektet e tregjeve.
- l) Objektet, rrjeti dhe pajisjet tjera të postë-telefonisë.
- m) Objektet, rrjeti dhe pajisjet tjera të energjisë elektrike.
- n) Nyjet sanitare publike.
- o) Tabelat, shenjat, panot, reklamat, gjelbërimi, lumenjt, përrockat, drunjët etj.
- p) Të gjitha objektet tjera, që nuk janë përshkruar këtu, por që sipas destinimit, formës ose punës së tyre mund të konsiderohen objekte komunale apo publike.

Neni 4

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale-publike, respektivisht të gjithë ata të cilëve u janë dhënë objektet në qeverisje, shfrytëzim (menaxhim) janë të obliguar që t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën sa më të mirë të përcaktuar me këtë rregullore, duke pas parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve, duhet të jetë në funksion të pamjes sa më të bukur të qytetit.

Neni 5

Qytetarët janë të obliguar që të sillen konform rregullave të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Qytetarët janë të ftuar që të kujdesen për realizimin e mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së objekteve duke bashkpunuar me institucionet dhe përgjegjësit për mirëmbajtjen e objekteve komunale dhe publike.

2. DEFINICIONET

Neni 7

" *Mbajtja e pastërtisë* ", konform dispozitave të kësaj Rregulloreje, nënkuptohet pastrimi dhe larja e sipërfaqeve publike me qëllim të largimit të të gjitha llojeve të mbeturinave dhe borës , pastrimi i rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, pastrimi i fekaljeve dhe ujërave të ndotur , gropave septike , largimi i kafshëve ose shpezëve të ngordhura si dhe pastrimi i mbeturinave të tjera.

Neni 8

" *Rregullimi i vendbanimit* ", konform dispozitave të kësaj rregulloreje, nënkuptohet: rregullimi i rrugëve, trotuareve, tregjeve, përmendoreve, monumenteve historike, ndriçimit publik , rregullimi i objekteve tjera komunale si dhe ndërmarrja e masave tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme me qëllim të mirëmbajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike.

Neni 9

" *Veprimtari komunale* ", konform dispozitave të kësaj rregulloreje, nënkuptohet: furnizimi i vendbanimeve me ujë (gjendje normale dhe emergjente), rregullimi dhe pastrimi i ujërave të përgjithshëm natyror, të lumenjve dhe ujërave të zeza, rregullimi i ujërave atmosferikë, pastrimi, grumbullimi, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave, ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve dhe kanaleve, ndërtimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e

parqeve, sipërfaqeve gjelbëruese, objekteve për pushim, rekreacion dhe sport, kryerja e punëve të ndriçimit të rrugëve , rregullimi i trafikut dhe transportit, furnizimin e banorëve me energji elektrike, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve, varrezave objekteve përkujtimore, objekteve publike, panairove etj.

Neni 10

" *Sipërfaqe publike* ", konform dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohen: sipërfaqet në të cilat është i lejuar, kalimi i numrit të pacaktuar të personave ose automjeteve, konform ligjit dhe kësaj rregulloreje, siç janë: sipërfaqet e trafikut publik rrugët dhe rrugët e rangut të dytë, stacionet e autobusëve, pikat e karburanteve, hapësirat e parkinjeve ,sipërfaqet publike të gjelbëruara, parqet, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion, terrenet sportive dhe argëtuese, stadiumet, kopshtet publike, tregjet, hapësirat e hapura midis dhe rreth ndërtesave dhe tokat e braktisura ndërtimore, oborret e banimit kolektiv, kinematë dhe sallat tjera që shërbejnë për takimet publike të njerëzve, varrezat dhe rrugët e varrezave.

Neni 11

" *Hapësirat tjera* ", konform dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohen ato hapësira që nuk janë hapësira publike por që shërbejnë për nevojat e ndërmarrjeve, organeve shtetërore, klubeve sportive, grupeve të qytetarëve, shoqatave joqeveritare si dhe grupeve të personave të caktuar.

Neni 12

" *Gropa Septike* ", në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen : gropat e ndërtuara në tokë me material të fortë, të mbyllura me kapakë që nevojiten për derdhjen, përkatësisht grumbullimin e ujërave të zeza dhe fekaljeve.

Neni 13

"*Ofrues i Shërbimeve* " do të thot ofruesi i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave , ofruesi i shërbimeve të hudhjes së mbeturinave ose ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, ose furnizuesi i ujit të papërpunuar, pra, të gjitha së bashku, janë "Ofruesit e shërbimeve".

Neni 14

" *Pusetat* ", në kuptimin e kësaj rregulloreje, konsiderohen gropat e ndërtuara në tokë me material të fortë që nevojiten për infrastrukturë komunale, si: ujësjellës, kanalizim, rrjet elektrik, rrjet telefonik, gropat për ndriçimin e hapësirave dhe bodrumeve, gropat për instalimin e pajisjeve për ngrohje etj.

3. RRUGËT

Neni 15

Rrugët janë sipërfaqe publike të pashtuara ose të shtruara me zhavorr ose asfalt dhe të destinuara për qarkullimin respektivisht lëvizjen e njerëzve, mjeteve tërheqëse ose automjeteve.

Neni 16

Rrugët e asfaltuara duhet të pajisen me shenja të komunikacionit sipas nevojës, shenja vertikale, horizontale ose me shenja drite, dhe të bëhet mirëmbajtja e tyre.

Neni 17

Urat, kanalet anësore, shenjat e komunikacionit, barrierat etj. janë pjesë përbërëse të rrugëve lokale dhe askush nuk guxon të ndërtojë pa leje të posaqme nga organi kompetent i administratës komunale.

Neni 18

Rrugët do të mirëmbahen në gjendje të mirë dhe të rregullt duke u bazuar në mundësitë financiare të buxhetit komunal, dhe do të shfrytëzohen në bazë të ligjit, rregullores dhe destinimit të tyre.

Neni 19

Mirëmbajtjen e rrugëve do ta kryejë ndërmarrja të cilës i është besuar kryerja e këtyre punëve.

Neni 20

Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale është e obliguar që të evitohet të gjitha dëmtimet e rrugëve dhe trotuarit dhe të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre.

Neni 21

Në shiritin e rrugëve të asfaltuara është e ndaluar lëvizja e të gjitha automjeteve ose mjeteve tërheqëse të cilat mund ta dëmtojnë rrugën siç janë: automjetet ose mjetet tërheqëse me zinxhirë, lloje të ndryshme të makinave ndërtimore ose industriale, që për nga mekanizmi lëvizës ose për nga pesha e madhe, mund ta dëmtojë strukturën e asfaltit.

Neni 22

Transportimi i makinave ose mjeteve të tjera, që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete të posaqme transportuese.

Neni 23

Ndalohet shfrytëzimi i sipërfaqeve të rrugëve dhe komunikacionit publik në kundërshtim me destinimin e tyre apo dëmtimi i tyre në çfarëdo forme.

Neni 24

Ndalohet tërheqja e armaturës nëpër rrugë, lidhja e armaturës në shtylla elektrike, drunj të gjlbërimit në sipërfaqe publike me qëllim të drejtimit të saj, shkapërderdhja e armaturës nëpër sipërfaqe publike, siç janë: rrugë, trotuare, parkingje, stacione, parqe, fusha sportive, oborret e ndërtesave publike si dhe lokacione të tjera publike.

Neni 25

Ndalohet transportimi i materialit ndërtimor, ushqimor ose tjetër, i cili nuk është i paketuar ose ngarkuar në rimorkio, në mënyrë të rregullt, konform rregullave të komunikacionit, i cili paraqet rrezik permanent për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion ose për këmbësorë.

Neni 26

Ndalohet kryerja e punëve ndërtimore ose vendosja e materialit ndërtimor në rrugë, trotuar ose sipërfaqe tjera publike, përveç rasteve të caktuara me leje të organit kompetent.

Neni 27

Në pjesët e rrugëve të asfaltuara, në të cilat ekziston trotuari për këmbësorë, është e ndaluar lëvizja e këmbësorëve nëpër shiritin e asfaltuar të rrugës.

Neni 28

Këmbësorët duhet të lëvizin nëpër trotuar. Kalimi në anën tjetër të rrugës duhet të kryhet në vendkalimet për këmbësorë, në vendet ku ekzistojnë shenjat.

Neni 29

Është e ndaluar derdhja e ujit (spërkatja) në rrugë të asfaltuar, në mnyrë të posaqme, gjatë sezonit të nxehtë veror. Lidhur me pastrimin dhe larjen e rrugëve duhet të kontraktohet ndërmarrja profesionale, e cila duhet të ketë parasysht kohën dhe momentin kur më së paku mund të ndikojë në dëmtimin e rrugës, duke e pastruar me ujë.

Neni 30

-Shenjat mbi emërtimin e rrugëve

Të gjitha rrugët e Komunës të Kaçanikut duhet të jenë të emërtuara dhe të pajisen me tabelat përkatëse mbi emërtimin e rrugëve.

Neni 31

Tabelat, së bashku me shtyllën mbi emërtimin e rrugëve, vendosen parimisht në udhëkryqe, në vendin më të përshtatshëm, ku dukshmëria është më e madhe, nga rruga për automjete dhe nga trotuari për këmbësorë.

Neni 32

Në sfondin e tabelës së rrugës shkruhet: emri i rrugës (psh. Anton Çetta), më poshtë shkruhet numri i shtëpisë së parë dhe të fundit (të ndarë me vizë psh. 1 - 45). Tabela vendoset në drejtim të rrugës për të treguar që nga numri 1 deri në numrin 45 të shtëpive gjinden në drejtimin e rrugës në të cilin është e drejtuar tabela.

Neni 33

Tabela e rrugës gjithmonë duhet të vendoset në drejtim të rrugës, prej ose nga vendi ku është vendosur Në qoftë se rruga vazhdon në drejtimin e kundërt të udhëkryqit, ose në drejtimin anash, prap duhet të vendoset një tjetër tabelë, e kthyer në drejtimin në të cilin vazhdon rruga.

Neni 34

Organi kompetent i administratës komunale, mbanë evidencë mbi rrugët dhe emërtimin e tyre, si dhe kryen me kohë ndërrimin e ndryshimit të evidencave, dhe fillon procedurën për emërtimin e rrugës ose rrugëve të reja.

Neni 35

-Numrat e shtëpive, sipas kësaj rregulloreje, duhet t'i kenë:

Çdo shtëpi e një ekonomie familjare.

Ndërtesa e banimit kolektiv.

Ndërtesat e institucioneve, objekteve hoteliere, sportive, bizneseve etj.

Neni 36

Organi kompetent i administratës komunale, vendos dhe mbanë evidencë mbi numrat e shtëpive, dhe kryen me kohë ndërrimin e ndryshimit të evidencave, cakton numrat e ri (vazhdues) për ndërtime të reja me banim të ri të familjeve.

Neni 37

Organi kompetent i administratës komunale, mbanë evidencë mbi lëvizjet e personave ose ekonomive familjare duke i lajmëruar, përkatësisht çlajmëruar ata, me qëllim ndërrimi të vendbanimit nga një komunë në tjetrën, kjo nënkupton ndërrimin e adresës së vendbanimit përkatësisht ndërrimin e numrit të shtëpisë.

Neni 38

Kuvendi Komunal duhet të vendosë, me vendim të veçantë, lidhur me mënyrën si dhe shpenzimet për projektin e vendosjes të numrave të shtëpive, ose mund të vendoset në nivel qendror.

Neni 39

Numri i shtëpisë duhet të vendoset në vend të dukshëm nga largësia, dhe mund të vendoset në murin e shtëpisë ose të rrethojës, në një lartësi optimale, me dimensione jo më të mëdha se 50x40, dhe jo më të vogël se 20x15 cm., preferohet që numri i shtëpisë të jetë me ndriçim ose me ngjyrë reflektuese.

4. TROTUARET

Neni 40

Trotuaret janë sipërfaqe publike (në shumicën e rasteve përrreth rrugëve, të shtruara ose të pashtuara), të cilat janë të destinuara për lëvizjen e këmbësorëve, si dhe karrocave të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 41

Nëpër trotuare është i ndaluar qarkullimi dhe parkimi i të gjitha llojeve të mjeteve dhe automjeteve, *përveç rasteve të lejuara*, të caktuara me shenjë të komunikacionit si zonë për qarkullim ose zonë për parkimin e automjeteve, si dhe në rastet e parapara me nenin 44 të kësaj rregulloreje për lejimin e shkarkimit të mallrave në kohë të caktuar. **Gjoha për automjete deri në peshën 7500 kg 20- 200 € për automjete mbi peshën 7500 kg 50 - 500 €.**

Neni 42

Është i ndaluar pengimi i qarkullimit të qytetarëve nëpër trotuare, duke pasë parasysh: shitjen, larjen e automjeteve, tregëtimin, punën në trotuar, aktivitetet sportive ose argëtuese, pushimin e parregullt, kërkimin e lëmshës, si dhe aktivitete tjera që pengojnë në lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Neni 43

Është e ndaluar hudhja ose vendosja në rrugë ose në trotuare, *pa leje të posaqme* të: dheut, gurëve, rërës, zhavorit, druve, tjegulla, blloka, gëlqere, çimento, armaturë, profile të ndryshme nga metali ose materiali tjetër, xhami, mbeturina të ndryshme ndërtimore, automjete ose pjesë të tyre, material tjetër për lule ose gjelbërim, objekte siç janë: vazne, guaska ose zbukurime të tjera nga materiali ndërtimor i të gjitha llojeve, ambalazhe dhe paketime të tjera, ose material tjetër që nuk është paraparë me këtë rregullore, por që e pengon qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve.

Neni 44

Shkarkimi i mallit në trotuar mund të bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet brenda ndërtesave, hallave, depove ose lokaleve afariste, ose në oborret e tyre. Malli i shkarkuar në trotuar duhet të largohet menjëherë e më së voni në afat prej një ore, pas shkarkimit të mallit.

Automjeti i ndalur në trotuar (në skajin e trotuarit ku më së paku pengon), mund të bëjë shkarkimin e mallit prej automjetit në lokalin afarist, ose në depo, në zonën një dhe dy të qytetit, prej ores: 8.⁰⁰h deri në ora: 10.⁰⁰h

Neni 45

Lidhur me kërkesat për shfrytëzimin e përkohshëm të trotuareve ose hapësirave të tjera publike, aty ku është e mundur një gjë e tillë, vendosë organi kompetent i administratës komunale me lëshimin e lejes për shfrytëzim të përkohshëm të lokacionit, duke paguar pala paraprakisht taksën komunale të paraparë me rregullore.

Neni 46

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar që trotuaret dhe sipërfaqet e tjera publike t'i shfrytëzojnë në përputhshmëri me lejen e lëshuar dhe me këtë rregullore. Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohen dëme, është paraparë, gjoba. Shfrytëzuesi është i obliguar që dëmet e shkaktuara ti kthejë në gjendjen e rregullt të mëparshme me shpenzimet e veta, nëse kjo nuk realizohet komuna do të kontraktojë një kompani për kryerjen e punëve me shpenzimet e shkaktuesit të dëmit.

Neni 47

Organi i administratës komunale, para dhënies së lejes për gropim, rrëmirje, prerje ose shpuarje të rrugëve, trotuareve ose sipërfaqeve të tjera publike mund të kërkojë që investitori ose punëkryesi, më parë të deponojë çekun e bariruar sipas vlerës së punëve, deri në mbarimin e punëve, lidhur me garantimin për rregullimin e sipërfaqeve, gjegjësisht kthimin në gjendje të mëparshme, në afatin e caktuar.

5. BARRIERAT (POLICËT E SHTRIRË)

Neni 48

Barrierat, ose siç njihen ndryshe në popull (policët e shtrirë), në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkuptojmë pengesat (të ngriturat) e vendosura në rrugë të asfaltuar nga materiali i fortë, të cilat kanë për qëllim ngadalësimin e shpejtësisë të automjeteve, në zonat me frekuentim të lartë të njerëzve dhe fëmijëve.

Neni 49

Barrierat mund të vendosen në rrugë, *vetëm me leje* të organit kompetent të administratës komunale, në rastet e veçanta dhe nën kushtet e parapara me ligj dhe me këtë rregullore.

Neni 50

Vendosja e barrierave në rrugë, pa leje, është e ndaluar.

Neni 51

Kërkesën për vendosje të barrierave mund ta paraqesin: institucionet, shoqatat, kompanitë, grupi i afaristëve, grupimet fetare, grupi i personave të një lagje ose bashkësie me nënshkrimet e tyre, etj.

Neni 52

Dokumentet që kërkohen për paraqitjen e kërkesës për vendosje të barrierave në rrugë janë:

- a) Kërkesa (për grupe, me nënshkrime),
- b) Pëlqimi nga policia për komunikacion, në të cilin duhet të jetë konstatuar se lokacioni për të cilin është bërë kërkesa, ku propozohet të vendosen barrierat, është zonë e rrezikut të vazhdueshëm, për lëvizje të lirë të këmbësorëve nga ngasjet e shpejta të automjeteve,
- c) Pëlqimi nga inspektori komunal për komunikacion,
- d) Për vendosje të barrierave në rrugët regjionale dhe maxhistrare, nevojitet pëlqimi nga Drejtoria e Rrugëve në kuadër të Ministrisë për Transport dhe Telekomunikacion –Prishtinë,
- e) Për vendosje të barrierave në zonat e urbanizuara nevojitet pëlqimi nga Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Rindërtim dhe Urbanizëm, në zonat e pa urbanizuara nuk nevojitet,
- f) Pëlqimi i kryetarit të vendbanimit,
- g) Skica me paramasë dhe specifikacioni,

Neni 53

Kushtet për lëshimin e lejes:

- a) Leja lëshohet në emrin dhe adresën parashtruesit të kërkesës.
- b) Në leje do të shenohet (perkufizohet) vendi ku duhet të vendoset barriera.
- c) Kohëzgjatja e lëshimit të lejes (e përhershme ose e përkohshme).
- d) Lartësia maximale e lejuar për vendosje të barrierave është **8 cm**, përveç barrierave speciale të gjata, të ndërtuara në rrugë, ngushtimit të rrugës me anë të oazave, barrierave të tjera speciale me blloka betoni, masa plastike me ujë, si dhe me profile speciale të metalit ose materiali tjetër.
- e) Vendosja e barrierave duhet të shoqërohet me dy shenja vertikale të komunikacionit (Barriera në rrugë) që vendosen në të dy kahjet e lëvizjes së automjeteve, nëse barrierat janë vendosur në të dy anët e rrugës.
- f) Shenjat vertikale të barrierave duhet të vendosen rreth 50 m. largësi nga barriera.
- g) Brinjët e barriers nuk guxojnë të jenë të vrazhda, që ndikon në masë të madhe në dëmtimin e gomës, ose automjetit në përgjithësi.
- h) Mbështetja e sipërfaqes së poshtme të barrierës me bazën duhet të jetë minimumi **30 cm**. përkatësisht duhet të jetë në harmoni me lartësinë e barrierës.
- i) Përforcimi (ankerimi) për bazën duhet të bëhet në mënyrë profesionale nga një kompani e specializuar, e cila bartë përgjegjësi për punën ose mospunën e saj.

Neni 54

Materiali për ndërtimin e barrierave mund të jetë nga: asfalti, betoni, metali, goma, goma e përzier, si dhe materiale ose profile speciale sipas trendeve të zhvillimit të shpejtë të komunikacionit.

Barrierat mund të jenë në formën e një gypti të prerë në mes dhe i vendosur horizontalisht në rrugë, në vijë të drejtë, vetëm në njërin kahje të rrugës ose në të dy kahjet, barriera

mund të ketë edhe të formave të tjera, të cilat mund të vendosen në vijën zik-zake ose mënyra tjera të ndryshme.

Neni 55

Barrierat mund t'i vendosë (duke u pajisur paraprakisht me leje), edhe qytetari me shpenzimet e veta, nga një kompani e specializuar, e cila bartë përgjegjësi për dëmtimet eventuale të rrugës ose çështje të tjera mbi përgjegjësinë e saj.

Neni 56

Mbikqyrjen mbi realizimin e projektit për vendosjen e barrierave e kryen Inspektori i Komunikacionit, ndërkaq, pranimin teknik e kryen inspektori së bashku me një zyrtar të Drejtorisë.

Neni 57

Në rastet kur parashtruesi i kërkesës për vendosje të barrierave nuk i është përmbajtur kushteve të parapara me rregullore gjatë punës së tijë, mbikqyrësi i projektit mund ta marrë lejen nga pala dhe të vendosë që puna e kryer deri atëherë të anulohet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Neni 58

Në rastet kur pala refuzon që ta bëjë këte, mbikqyrësi do të kujdeset që të gjejë një kompani e cila do t'i kryejë punët e kthimit në gjendje të mëparshme me shpenzime të parashtruesit të kërkesës. Nëse kjo nuk është e mundur të realizohet, inspektori pas konstatimit të gjendjes dhe varësisht nga shkaktimi i demit, mund të shqiptojë masën e dënimit me gjoba.

6. PASTRIMI I RRUGËS NGA BORA

Neni 59

- Pastrimi i rrugëve nga bora:

Pastrimi i rrugëve nga bora dhe akullit, në rrugët lokale të komunës së Kaçanikut, i kryen ndërmarrja, të cilës i janë besuar kryerja e punëve për pastrimin e rrugëve nga bora dhe akulli.

Neni 60

Ndërmarrja, të cilës i është besuar kryerja e punëve të pastrimit të bores, është e obliguar që brenda sezonit dimëror nga data: *15 nëntor deri më 15 mars* të vitit vijues të bëj pastrimin e rrugëve lokale të komunës së Kaçanikut nga bora dhe akulli, kështu që të mundësojë qarkullimin e lirë të njerëzve dhe automjeteve.

Për kryerjen e punëve, ndërmarrja do të paguhet sipas çmimit të ofruar dhe të vendosur nga komisioni për vlerësimin e ofertave, të saktësuar me kontratën për kryerjen e shërbimeve.

Mbikqyrjen dhe vlerësimin lidhur me procesin e kryerjes së punëve për pastrimin e borës dhe hudhjen e kripës industriale do ta bëjë shërbimi i inspektoratit komunal.

Ndërmarrja do të kryej pastrimin nga bora të rrugëve lokale sipas udhëzimeve dhe prioriteteve të caktuara me anën e kontratës për kryerjen e punëve.

Gjatë kohës së reshjeve të borës pastrami i rrugëve duhet të bëhet pandërprerje. Prioritet dhe kushtet për pastrim të borës do të përcaktohen nga drejtori i drejtorisë përkatëse.

Neni 61

- Pastrimi i borës nga trotuaret

Lidhur me pastrimin (grumbullimin dhe transportimin) e borës dhe akullit nga zonat publike në qendër dhe trotuare, gjatë sezonit dimëror, do të kujdeset ndërmarrja e zgjedhur së cilës i janë besuar kryerja e këtyre punëve.

Neni 62

Pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave afariste, si dhe grumbullimin e saj në skaj të trotuarit ku pengon më së paku, e kryen pronari ose shfrytëzuesi i lokalit afarist.

Neni 63

Pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave të ekonomive familjare, si dhe grumbullimin e saj në skaj të trotuarit ku pengon më së paku, e kryen pronari ose shfrytëzuesi i ndërtesës, shtëpisë ose objektit që gjendet rreth trotuarit.

Neni 64

Pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave të banimit kolektiv , si dhe grumbullimin e saj në skaj të trotuarit ku pengon më së paku, e kryen personi i zgjedhur nga (këshilli, pleqësia familjare ose përgjegjësi i ndërtesës).

Neni 65

Pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave të institucioneve ose shoqatave të ndryshme, si dhe grumbullimin e saj në skaj të trotuarit ku pengon më së paku, e kryejnë pastruesit e autorizuar të tyre.

Neni 66

Pastrimin e borës në pjesët e trotuareve ku nuk ka ndërtesa, ose hapësirat e shesheve, vendkalimet në parqe, vendkalimet në ura, vende për të cilat nuk përkujdeset askush etj., do t'i kryejë ndërmarrja e zgjedhur sipas nenit 61 të kësaj rregullore.

Neni 67

Ndërmarrja e zgjedhur do të kujdeset edhe për hudhjen e kripës industriale në trotuaret ku formohet akulli, sipas nevojës.

Neni 68

Ndërmarrja e zgjedhur për pastrim është e obliguar që borën dhe akullin e grumbulluar në skaje të trotuarit, ta largojë menjëherë jashtë qytetit, e më së voni brenda 6 orëve nga momenti i marrjes së urdhërit nga mbikqyrësi ose organi kompetent i administratës komunale.

Neni 69

Gjatë sezonit dimëror ndërmarrja e zgjedhur për pastrim ka për obligim që të sigurojë këmbësorëve lëvizje të lirë dhe të sigurtë nga bora dhe akulli në trotuarin, dhe zonat publike të qendrës së qytetit.

7. UJËSJELLËSI

Neni 70

70.1. Të gjitha sistemet e ujësjellësit në komunën e Kaçanikut do të menaxhohen nga ndërrmarrja të cilës i janë besuar punët e menaxhimit nga Kuvendi Komunal në Kaçanik, (Në tekstin e mëtejme –Menaxhuesi).

70.2. Menaxhuesi e ka për detyrë që konsumatorëve të ju sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit higjenik.

70.3. Komuna dhe Menaxhesi kanë për obligim të respektojnë rregullativat dhe standartet e vendosura nga autoritetet qendrore për ujë.

Neni 71

Menaxhuesi e ka për detyrë që të mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit bashkë me nyjet dhe stabilimentet përcjellëse të sistemit të ujësjellësit.

Neni 72

Menaxhuesi, kontrolluesi dhe konsumatori kanë për detyrë të parandalojë dhe të pengojë çdo derdhje të ujit të pa kontrolluar si dhe keqpërdorimin e ujit të pijes.

Neni 73

Të gjithë qytetarët, sipas kësaj rregulloreje, janë të obliguar që ujin e pijes ta përdorin në mënyrë racionale sidomos në periudhën e nxehtë të verës, konsumimi i ujit duhet të reduktohet deri në shkallën normale me qëllim që të ruhet për furnizimin me ujë për të gjithë.

Detyrimi i furnizimit me ujë mund të mos vlejë në rastet:

- të veprimit të fuqisë madhore, (Vis Major)
- të defekteve ose pengesave të befashme në repartet teknike, pa fajin e ndërrmarrjes,
- të ndërprerjes së furnizimit të repartit me energji elektrike,
- gjatë kryerjes së punëve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në meremetimin e pajisjeve të ujësjellësit.

Neni 74

Në qoftë se paraprakisht është planifikuar ndërprerja e furnizimit me ujë, ndërrmarrja ka për detyrë që më së paku **24 orë** përpara t'i njoftojë shfrytëzuesit me ndërprerjen e planifikuar të ujit.

Neni 75

Rrjeti i sistemit të ujësjellësit fillon nga vend-burimi i ujit dhe shpërndahet në vendbanimin ose vendbanimet e dedikuara me projekt, ndërkaq që rrjeti përfundon me kufirin gjeodezik-kadastral të vendbanimit, rrjeti mund të vazhdohet vetëm në rastet e veçanta të lejuara nga organi kompetent i administratës komunale dhe në qoftë se plotësohen kushtet teknike dhe nuk zvoglohet sasia e nevojshme e ujit për konsumatorët e vendbanimit për të cilin është dedikuar ujësjellësi.

Neni 76

Menaxhuesi duhet të ketë një kopje të projektit final të sistemit të ujësjellësit, si dhe duhet që të përcjellë çdo ndryshim ose shtim të pozicioneve të projektit me anekse shtesë, ky duhet të jetë në gjendje që në çdo moment të ofrojë shenime për gjendjen teknike dhe të përgjithshme të sistemit të ujësjellësit.

Neni 77

-Kycja në rrjetin e Ujësjellësit

Ndalohet kycja pa leje në rrjetin e sistemit publik të ujësjellësit.

Neni 78

Pëlqimin për kycje në rrjetin e ujësjellësit, sipas kërkesës së konsumatorit, e lëshon ndërrmarrja të cilës i janë besuar këto punë duke respektuar dispozitat e kësaj rregullore dhe duke ju përmbajtur dispozitave sanitare dhe teknike mbi vendosjen e rrjetit të ujësjellësit.

Neni 79

Shpenzimi i ujit paguhet për: m³ të llogaritur me anën e ujëmatësit sipas tarifës të propozuar nga menaxhuesi dhe miratuar nga organi kompetent.

Neni 80

80.1. Uji i cili konsumohet nga konsumatorët duhet të matet me Ujëmatës, përveç në rastet kur uji nga sistemi I ujësjellësit shfrytëzohet për hidrantët e zjarrit, si dhe rasteve të përcaktuara me këtë Rregull. Ofruesi i Shërbimeve të Ujit do të përcaktojë diametrin dhe llojin e Ujëmatësit i cili instalohet në secilin rast.

80.2. Ujëmatësit duhet të instalohen, zëvendësohen, apo zhvendosen vetëm nga punëtorët e autorizuar të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit. *Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të instalojë, ndërrojë ose zhvendosë ujëmatësin pa lejen me shkrim nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit.*

Neni 81

Nëse prishet ujëmatësi ndërrmarrja do të caktojë shumën paushale të pagimit në bazë të mesatarës tremujore të ujit të shpenzuar derisa ka punuar ujëmatësi. Paga në këtë formë do të kryhet prej momentit të prishjes së ujëmatësit dhe deri në momentin e rregullimit të ujëmatësit.

Neni 82

Vënia, meremetimi ose ndërrimi i ujëmatësit kryhet me shpenzimet e pronarit, përkatësisht të shfrytëzuesit të ujësjellësit, (përveç rasteve të projekteve të përgjithshme,) ndërsa punët mund të kryhen nga Menaxhuesi, ose kompani tjetër duke respektuar kushtet e lejes për kycje, kushtet teknike, dhe respektimin e rregullores.

Neni 83

Shpenzimet e kycjes dhe shpenzimet tjera të lidhjeve, dhe të kycjes së përsëritur i heq pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i ujësjellësit sipas mënyrës dhe tarifës të ndërrmarrjes për furnizim me ujë.

Neni 84

Ndërrmarrja ka të drejt ta mbyllë (ndërprejë) ujin në ujësjellësin e shfrytëzuesit në këto raste:

- Në rastet e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit pa leje,
- Në rastet e shfrytëzimit të ujit në mënyrë jo të rregullt, keqpërdorimit, përdorimi pa ujëmatës etj.
- Në rastet kur konsumatori ka ujëmatës, ka lejen për kyçje, dhe është parapagues i rregullt i ujit, por që krijon shpenzime të tepruara të ujit duke kryer: ujitje, larje të automjeteve, pishina etj.
- Ujitje të kopshteve, larje të automjeteve me qëllim të fitimit, shpenzime të larta të ujit në fabrika, industri ose biznese të ndryshme etj. (Këto duhet të kenë burimin e vet të ujit).
- Në rastet kur faktura për ujin e shpenzuar nuk paguhet brenda afatit prej 8 ditësh pas marrjes së vërejtjes me shkrim,
- Kur konsumatori i vjetër shpërngulet-ikë ndërsa konsumatori i ri nuk e paraqet gjendjen për sasinë e ujit të shpenzuar dhe nuk merr përsipër pagesën e faturës për ujin e shpenzuar,
- Kur kryhet meremetimi, eliminimi i pengesave dhe dëmtimeve në rrjetin e ujësjellësit,
- Kur instalimi i ujësjellësit i dëmton shfrytëzuesit e vet, përkatësisht cilësia e ujit në rrjetin e ujësjellësit nuk është e mirë,
- Nëse puseta e ujësjellësit ku është i vendosur ujëmatësi është e ndotur e mbyllur e penguar ose e prishur ndërsa konsumatori, edhe pasi i është tërhequr vërejtja me shkrim nga kompetentët, nuk ka ndërmarrë veprime për eliminimin e pengesave të pusëtës,
- Me rastin e intervenimit vetiak, prishjes së bllobës në ujëmatës e cila është vendosur nga organi kompetent.
- Me rastin e zgjerimit të rrjetit të gypave ilegal, para se të arrijë te ujëmatësi, (vjedhja e ujit).
- Përveç ndërprerjes të ujit në rrjetin e ujësjellësit, sipas këtij neni konsumatorit mund t'i shqiptohet edhe gjoba.

8. UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Neni 85

Uji sipërfaqësor i lumenjve dhe i përrockave duhet të lëvizë në shtratin dhe pjerrtësinë e tyre natyrore.

Neni 86

Ndryshimi i rrjedhës së ujit sipërfaqësor mund të bëhet vetëm duke arritur mirëkuptim me të gjithë personat e involvuar në mënyrë direkte me ndryshimin e rrjedhës së ujit sipërfaqësor dhe me leje të organit kompetent të administratës komunale.

Neni 87

Uji sipërfaqësor i kanaleve të rrugëve nuk guxon të pengohet në lëvizjen e tij natyrore dhe në këtë kuptim, kanalet e rrugëve duhet të jenë të hapura duke u bazuar në sasinë e mundshme të lëvizjes së ujit sipërfaqësor dhe konfiguracionit të tokës.

Neni 88

Në çdo vendkalim nga rruga në pronat e paluajtshme, qytetari duhet të bëjë të mundur qarkullimin e lirë të ujit sipërfaqësor duke ndërtuar ura ose gypa, ndërkaq në qendrat e urbanizuara duhet të ekzistojë dhe funksionojë kanalizimi atmosferik.

Neni 89

Ura ose gypat duhet t'i vendosë pronari ose shrytëzuesi i pasurisë së paluajtshme, edhe atë në përputhje të plotë me sasinë e mundshme të qarkullimit të ujit sipërfaqësor edhe në rastet e të reshurave atmosferike.

Neni 90

Ura ose gypat nuk mund të vendosen në nivelin më të lartë se sa shtrati i kanalit në të cilin lëvizë uji sipërfaqësorë.

Neni 91

Është e ndaluar çfarëdo derdhje e ujërave të zeza në shtratin e lumenjve, përrockave, kanaleve të rrugëve si dhe kanaleve të tjera, që janë në lidhje të drejtëpërdrejt ose indirekt me vendbanimin dhe që ndikojnë në shëndetin e qytetarëve. Deri në arritjen e sigurimit të kushteve për aplikimin e kësaj dispozite, duhet të sigurohet trajtim paraprak për ujrën e zeza aktuale.

Neni 92

Është e ndaluar në mënyrë rigoroze, hudhja e çfarëdo mbeturine në lumenj, përrocka, kanale, lugje, ose burime të tjera të ujërave sipërfaqësor.

Neni 93

Është i ndaluar turbullimi i ujit, posaqërisht ndotja e lumenjve, përrockave dhe derdhja e kemikalieve, ngjyrave, vajrave, fekalieve si dhe materieve të tjera shtëpiake, ndërtimore ose industriale.

Neni 94

Është e ndaluar nxjerrja nga lumi ose pastrimi i gurëve, dheut ose zhavorrit, me qëllim përvetësimi ose përfitimi duke e dëmtuar botën bimore dhe shtazore të *ujërave sipërfaqësor*.

Neni 95

Në qoftë se paraqitet nevoja për drejtimin, zgjerimin ose rregullimin e shtratit të lumit, përrockës, ose kanalit, personi fizik ose juridik duhet që paraprakisht të pajiset me leje të posaqme nga organi kompetent i administratës komunale, në të kundërtën për devijimin e shtratit është paraparë gjoja.

Neni 96

Nuk është i lejuar përvetësimi ose shfrytëzimi për vete i sipërfaqeve të tokës në lumenj ose për rreth bregut të tij, qoftë edhe përkohësisht, në qoftë se nuk është pronë e tij.

Neni 97

Nuk është e lejuar mbjellja e fidaneve të drunjve të ndryshëm në shtratin e lumit, në bregun e tij dhe në afërsi të bregut, ku këto fidane në të ardhmen do të pengonin rrjedhjen e lirë të ujit të lumit ose përrockës.

9. KANALIZIMI FEKAL

Neni 98

Me të gjitha sistemet e kanalizimit fekal dhe atmosferik në komunën e Kaçanikut, menaxhon ndërmarrja të cilës i është besuar kryerja e punëve, me vendim të Kuvendit Komunal.

Neni 99

Sipas kërkesës së tij, secili qytetar, pa dallim, ka të drejtë të kyçet në rrjetin e kanalizimit publik fekal duke i plotësuar, paraprakisht, kushtet teknike për t'u kyçur, (konfiguracioni i tokës për ramje të lirë 1-3 %).

Neni 100

Për tu kyçur në rrjetin e kanalizimit, nevojitet leje e posaqme, të cilën e lëshon ndërmarrja të cilës i janë besuar kryerja e punëve dhe menaxhimi me rrjetin e kanalizimit fekal dhe atmosferik, në të kundërtën është paraparë gjoba.

Neni 101

Është i ndaluar ndërtimi ose vendosja e çfarëdo objekti mbi rrjetin dhe mbi pusetat e kanalizimit fekal, kanalizimit atmosferik, kanalizimit të rrjetit të telefonisë, të energjisë elektrike, të rrjetit të ujësjellësit, si dhe objekteve të tjera publike, përveç rasteve me leje të vecntë nga organi kompetent.

Neni 102

Secili sistem i kanalizimit fekal, i cili është i ndarë fizikisht, duhet të ketë impiantin për pastrimin e ujërave fekalë.

Neni 103

Ujërat fekalë nuk është e lejuar që të zbrazen, derdhen, lëshohen, ose kullohen në hapësirat publike, lumenj, liqej, përrocka, kanale të ndryshme ose në rrjetin e kanalizimit atmosferik, pa u trajtuar. Gjoba për personin juridik 50 - 500 € , për personin fizik 25 - 100 €. (Implementimi i gjobave mund të fillojë pasi të jetë ndërtuar Impianti për trajtimin e ujërave të zeza, ose zgjidhje tjetër).

Neni 104

Kanalizimi shtëpiak, sipas kësaj rregulloreje nënkupton, rrjetin e gypave të kanalizimit shtëpiak, që fillon nga kyçja në pusetë të kanalizimit publik deri në mbarimin e gypave në objektin e banimit. Shpenzimet për mirëmbajtjen, e kanalizimit, ose renovimin e kanalizimit shtëpiak i paguan shfrytëzuesi ose pronari i objektit.

Neni 105

Kanalizimin publik, sipas kësaj rregulloreje, nënkupton, rrjetin e gypave ose te kanalit publik për bartjen e ujërave të zeza dhe fekalieve, për ndërtimin, rregullimin, ose menagjimin e të cilit përkujdeset komuna.

Neni 106

Shpenzimet për mirëmbajtjen e kanalizimit publik, fekal dhe atmosferik i bartë ndërmarrja, të cilës i është besuar kryerja e punëve për menaxhimin e sistemit të kanalizimit.

Neni 107

Ndërmarrja, të cilës i është besuar kryerja e punëve të menaxhimit me sistemet e kanalizimit, gëzon të drejtën për caktimin dhe grumbullimin e taksave për kycjen në kanalizim dhe shfrytëzimin e kanalizimit nga qytetarët. Shuma për caktimin e çmimit të taksave, me propozim të ndërmarrjes, duhet të jetë e miratuar në Kuvendin Komunal.

Neni 108

Në vendbanimet ku nuk është i ndërtuar rrjeti i kanalizimit, përveç nyjeve sanitare të brendshme, mund të ndërtohen nyje sanitare higjenike të fushës, të cilat duhet të jenë të lidhura, përmes gypave, me gropat septike.

Neni 109

Pastrimin me kohë të nyjeve sanitare dhe gropave septike, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve, e kryen ndërmarrja që ka për detyrë mirëmbajtjen e kanalizimit ndërsa për mirëmbajtjen dhe pastrimin e gropave me interes të përbashkët, kujdesen ndërmarrjet, organizatat, institucionet, këshillat shtëpiake, përkatësisht pronarët e ndërtesave e personat tjerë fizikë dhe juridikë, të cilëve u shërbejnë këto.

10. NYJET SANITARE PUBLIKE

Neni 110

Nyjet sanitare publike, janë të ndërtuara, veçmas ose në objektet ku mund të aderojnë numër i pa kufizuar i personave, këto janë të destinuara për freskim me ujë, si dhe kryerjen e nevojave fiziologjike, ndërkaq, keqpërdorimi, dëmtimi ose përdorimi për nevoja të tjera nuk është i lejuar.

Neni 111

Nyjet sanitare publike duhet të ndërtohen në përputhje të plotë me këtë rregullore si dhe kushtet higjeniko-teknike.

Neni 112

Mirëmbajtja, pastrimi dhe dezinfektimi i kohëpaskohshëm i nyjeve sanitare publike, sipas kësaj rregulloreje, konsiderohet aspekti kryesor dhe shumë i rëndësishëm i mbajtjes së higjienës dhe pastërtisë publike.

Neni 113

Pastrimin dhe dezinfektimin e kohëpaskohshëm (minimumi një herë në javë), të nyjeve sanitare publike, e kryen pronari ose shfrytëzuesi i objektit ku gjindet nyja sanitare.

Neni 114

Mirëmbajtjen e nyjeve sanitare publike e kontrollon Inspektori Komunal Sanitar. Në rastet e konstatimit të papastërtisë, inspektori ndërmerr masat e paralajmërimit dhe vërejtjes, ndërkaq, në rastet e përsëritjes, ndërmerr masat e ndëshkimit, sipas nenit 113.

Neni 115

Nyje sanitare, të ndara për të dy gjinitë, duhet të kenë: objektet e institucioneve, objektet

hoteliere, sportive, dhe rekreative, pushimoret, stacionet hekurudhore, të autobusëve dhe aeroportet, objektet e bizneseve, punëtoritë shtetërore dhe private, kinematë, teatrot, panairët, tregjet, objektet për mbrojtjen e shëndetit, kampet, pikat e karburanteve, objektet fetare etj.

Neni 116

Personave me aftësi të kufizuar duhet që t'ju mundësohet qasja e papenguar në objektet publike, përkatësisht në nyjet sanitare publike.

Neni 117

Pronari ose investitori, i cili posa ka filluar ndërtimin e objektit ndërtimor, është i obliguar që gjatë kohës së ndërtimit të sigurojë nyje sanitare (të lëvizshme) të përkohshme.

11. GROPAT SEPTIKE

Neni 118

Në vendbanimet ku nuk ekziston sistemi i kanalizimit fekal, qytetarët janë të obliguar që të ndërtojnë nyje sanitare higjienike të fushës me gropa septike.

Neni 119

Gropat Septike janë gropa të ndërtuara në tokë me material të fortë, të mbyllura me kapak, të cilat nevojiten për derdhjen, përkatësisht grumbullimin e ujërave të zeza dhe fekalieve të ekonomive familjare, institucioneve, bizneseve ose grupeve të ndryshme të banuesve të përbashkët.

Neni 120

Madhësia e gropës septike duhet të jetë në përputhje të plotë me numrin e banorëve ose sasinë e derdhjeve. Madhësia e preferuar e gropës septike për një ekonomi familjare është: **2x3x2 m.**

Neni 121

Gropat septike ndërtohen, në vendbanime, në lokacione ku nuk ndikohet ose ndikohet më pak në objektet e ujit të pijes (30m larg objekteve të ujit- puseve) dhe 20 m nga objektet banesore të afërta dhe rruga, varësisht nga konfiguracioni i terrenit. Në qendrat, ku banimi është i dendur dhe mungon rrjeti i kanalizimit, gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave, dhe duhet të jenë të larguara nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe të ndërtesës së fqiu, më së paku **2 m.** nëse nuk ekziston asnjë mundësi tjetër për tu larguar më tutje.

Neni 122

Gropat septike duhet të pastrohen me kohë (së paku një herë në muaj). Sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve, pastrimin e gropave septike e kryen ndërmarrja që ka për detyrë mirëmbajtjen e kanalizimit. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e gropave septike me interes të përbashkët, kujdesen ndërmarrjet, organizatat, institucionet, këshillat shtëpiake, pronarët e ndërtesave ose personat tjerë fizikë dhe juridikë, të cilët i shfrytëzojnë këto gropa.

Neni 123

Gropat septike nuk është e lejuar të ndërtohen në rrugë, në trotuare ose në sipërfaqe të tjera publike pa leje të posaqme. Lejen për ndërtimin e gropës septike e lëshon Drejtoria për Urbanizëm me pëlqim të Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe Inspektorit Sanitarë.

12. MBETURINAT

Neni 124

Për menaxhimin me mbneturina në komunën e Kaçanikut përkujdeset ndërrmarrja së cilës i është besuar kryerja e këtyre punëve. (Më tej, Ndërrmarrja për menaxhimin e mbeturinave organike).

Neni 125

Komuna mund të zgjedhë një kompani private ose publike, e cila do të menaxhojë me mbeturinat, të ashtuquajtura jo organike (Ricikluese, shih neni 145 të kësaj rregullore).

Neni 126

Ndërrmarrja për menaxhimin e mbeturinave organike, sipas kësaj rregulloreje, është e obliguar që të organizojë të gjithë sistemin për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, në të gjithë territorin e komunës së Kaçanikut.

Neni 127

Ndërrmarrja për menaxhimin e mbeturinave organike sipas kësaj rregulloreje është e obliguar që të organizojë dhe furnizojë ekonomitë familjare, bizneset, institucionet, shoqatat dhe bashkësitë tjera me kontejniera ose mjete të tjera, ose të organizojë forma të tjera të grumbullimit të mbeturinave, dhe të njoftojë qytetarët për planet e tyre të menaxhimit me mbeturina, mirëpo në rastet e vullnetit të mirë, qytetarët vetë mund të pajisen me mjete për grumbullimin e mbeturinave dhe ndërrmarrja është e obliguar që t'ju kryejë shërbimet e pastrimit të enëve.

Neni 128

Grumbullimi, transporti dhe derdhja e mbeturinave organike bahet në deponi të mbeturinave dhe duhet të planifikohet nga ndërrmarrja që të kryhet në orët e vona të mbrëmjes, në orët e hershme të mëngjesit, në kohën kur nuk pengon qarkullimin e lirë të njerëzve dhe automjeteve.

Neni 129

Ndërrmarrja për menaxhimin e mbeturinave organike, gëzon të drejtën për grumbullimin e tarifave të pagesës për mbeturina nga ana e qytetarëve. Lidhur me lartësinë e tarifave për shërbimet e ofruara qytetarëve, me propozimin e Ndërrmarrjes, duhet të miratohen në Kuvendin Komunal.

Neni 130

-Pastërtia në hapësirat publike

Për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës komunale, në qendër të urbanizuar: sheshe, trotuare, rrugë, parqe, tregje, parkingje, stacione ose vendalje të autobusëve dhe taksive, etj. kujdeset komuna ose ndërrmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë, të cilës i është besuar kryerja e punëve të higjienës publike dhe të menaxhimit të mëtejshëm të mbeturinave.

Neni 131

Për përkujdesje të rregullt dhe me qëllimin e mirë për mirëmbajtjen e pastërtise dhe të higjienës publike në trotuare dhe zona tjera të pa urbanizuara, para ndërtesave të banimit , lokaleve afariste dhe të tjera, përkujdesen pronarët , përkatësishtë shfrytëzuesit e atyre sipërfaqeve ose objekteve.

Neni 132

Mbeturinat hudhen vetëm në mjetet e destinuara për hudhjen e mbeturinave, ose në deponinë e licencuar dhe të autorizuar për grumbullimin e mbeturinave.

Neni 133

Është e ndaluar hudhja e çfarëdo lloji të mbeturinave, në rrugë, trotuar, parqe, lumenj, përrocka si dhe hapsirat tjera publike, fusha dhe hapsira tjera të pa shfrytëzuara. Për hudhjen e mbeturinave për herë të parë është paraparë gjoba më e vogël.

Neni 134

Është e ndaluar fillimi i krijimit të deponive të egra, ose përsëritja e hudhjes së kohë pas kohshme të mbeturinave në vende të caktuara, fusha, vende të pashfrytëzuara ose pyll. Për rastet e përsëritura të hudhjes së mbeturinave është paraparë gjobë më e madhe.

Neni 135

Është e ndaluar hudhja e automjeteve të havarisura, të vjetra ose të papërdorshme, hudhja e pajisjeve shtëpiake të vjetra si dhe mbeturinave të tjera në rrugë, trotuar, lumenj, përrocka si dhe në sipërfaqet tjera publike, fusha dhe hapësira të pashfrytëzuara.

Neni 136

Është i ndaluar keqpërdorimi i kontejnierëve ose mjeteve të tjera për grumbullimin e mbeturinave, vjedhja e tyre, dëmtimi, shkrimi, vizatimi, ngjyrosja, praptimi, ndezja, hapja pa nevojë e kapakëve, derdhja në tokë të mbeturinave ose lëvizja e kontejnierëve prej një vendi në vendin tjetër.

Neni 137

Pastrimin, larjen e rrugës, dhe largimin e mbeturinave dhe borës (sipas kontratës) nëpër rrugë dhe trotuare, ndërmarrja ka për detyrë t'i largojë sipas mënyrës dhe kohës, e cila siguron efektin më të mirë të pastrimit.

Neni 138

Kompanitë ose ndërmarrjet, të cilat menaxhojnë me terrenet sportive dhe argëtuese, ose hapësira të tjera për rekreacion, kanë për detyrë të përkujdesën për pastërtinë dhe higjienën e terreneve dhe objekteve si dhe për rregullsinë e pajisjeve në to.

Neni 139

Pastrimi, transporti, dhe deponimi i mbeturinave nga sipërfaqet publike kryhet nga Ndërmarrja që ka për obligim, që rregullisht dhe sipas planit të miratuar në Komunë të zbrazë dhe të pastrojë enët e mbeturinave: kontejnierët, kovat, enët e madhësive të ndryshme, thasët, qeset të najllonit ose mjete të tjera për grumbullimin e mbeturinave.

Neni 140

Ndërmarrja gjatë kryrjes së punëve duhet të ketë kujdes që me rastin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave të mos shpërndahen nëpër rrugë ose sipërfaqe publike.

Neni 141

Mbeturinat shtëpiake duhet të grumbullohen nga banorët, në enët e caktuara për mbeturina (kontejnerë, kova, enët e ndryshme, thasë ose qese të ndryshme), të cilat duhet të kenë kapakët e tyre, ose thasë të lidhur dhe vendosen në vendet e mbrojtura dhe të përshtatshme për bartje, jashtë sipërfaqeve ku nuk pengohet qarkullimi i lirë i komunikacionit. Nuk është e lejuar derdhja e mbeturinave në tokë ose përrreth kontejnierëve.

Neni 142

Ndërmarrja ka për detyrë që mbeturinat t'i largojë, më së paku një herë në javë, në kohë të caktuar, mbeturinat e shportave të rrugës ose parqeve, të pastrohen për çdo ditë mbeturinat në qendër, nga bizneset dhe dyqanet tjera zejtare pastrohen së paku dy herë në javë. Organi kompetent i administratës komunale mundet në rastet e jashtëzakonshme kohore dhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të caktoj që në pjesët e caktuara të qytetit, mbeturinat të mënjanojnë për më shumë herë.

Neni 143

Ndërmarrja nuk do t'i kryejë askujt shërbimet e largimit të mbeturinave që nuk janë të pajisura me mjete përkatëse për vendosjen e mbeturinave.

Neni 144

Largimi i mbeturinave shtëpiake, fekalieve dhe ujërave të zeza nga nyja sanitare si dhe pastrimi i gropave septike, mund të bëhet vetëm me mjete të destinuar dhe pajisura për këtë qëllim në mnyrë që të mos shkaktohet shpërndarja e mbeturinave si dhe derdhja e fekalieve dhe ujërave të ndotura në sipërfaqet publike ose rrugë.

Neni 145

Mbeturinat joorganike (Ricikluese) siç janë: metali, plastika, kauçuku, goma, druri, tekstili, xhami, folia, letra (kartoni) etj, transportohen nga vetë qytetarët ose kompanitë e interesuara, për në vendet ose qendrat e caktuara për grumbullimin, ose përpunimin (riciklimin) e mbeturinave.

Neni 146

Kompanitë e licencuara për përpunimin ose menaxhimin e mbeturinave ricikluese kanë të drejtë që të kërkojnë leje për grumbullimin e mbeturinave ricikluese ose leje për formimin e një ose më shumë qendrave për grumbullimin e mbeturinave ricikluese si dhe vendosje të kontejnierëve, në vende të caktuara për grumbullimin e mbeturinave ricikluese. Personat ose kompanitë e palicencuara si dhe ato pa leje, mund të denohen me gjobë.

Neni 147

Ndërmarrjet kanë për detyrë që organeve të Inspektionit kompetent komunal dhe Inspektionit të rrugëve publike, t'i paraqesin planin e largimit të mbeturinave për muajin ose vitin e ardhshëm, më së largu deri më datën 15 të muajit janar ose për muajin vijues.

13. GJELBËRIMI

Neni 148

Me qëllim të ruajtjes, zgjerimit, mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbëruara, mbjelljes të drunjve të ri në sipërfaqet publike të komunës së Kaçanikut, me këtë rregullore vëhen nën mbrojtje të caktuar këto sipërfaqe të gjelbëruara:

- Sipërfaqet publike të gjelbëruara, në qendër të qytetit, parqet, sheshet, kthesat, drunj të rreth rrugës, parkingjet, gjelbërimi në lagjet e banesave etj.
- Pjesa qendrore e qytetit, paratagjet, zonat e mbrojtura dhe zonat industriale,
- Sipërfaqet e gjelbëruara përrreth objekteve të institucioneve, kompanive, shoqatave, ndërmarrjeve publike, bizneseve, dhe subjekteve të tjera.
- Sipërfaqet e ashtuquajtura me destinime të veçanta dhe të dobishme,
- Gjelbërimi rreth varrezave, objekteve përkujtimore, objekteve kulturore dhe historike, si dhe të objekteve të tjera me rëndësi.
- Sipërfaqet e gjelbëruara për sport dhe rekreacion, oborret shkollore, terrenet sportive, vendet për shetitje dhe rekreacion, lokacionet për vikend dhe kamping.
- Sipërfaqet përrreth objekteve hoteliere, motele, bujti, dhe pushimore të ndryshme.
- Sipërfaqet përrreth rrugëve, lokale dhe rajonale, lumenjve, përrockave, kanaleve, burimeve të ujit (puset) sipas zonave mbrojtëse të tyre, rezervuaret, si dhe rreth objekteve të tjera përcjellëse.

Neni 149

Pikat e nenit 148 të kësaj Rregulloreje, nuk kanë të bëjnë me pyjet, kodrinat e zhveshura, djerrinat, tokat bujqësore dhe pjesë të tjera të natyrës për të cilat aplikohen dispozita të tjera.

Neni 150

Punët e gjelbërimit: mbjelljes, shortimit, prerjes, krasitjes, spërkatjes, mbështjelljes, rrethimit dhe mbrojtjes të sipërfaqeve të gjelbëruara, sipas kësaj rregulloreje, i kryen komuna apo ndërmarrja e specializuar, të cilës i besohen këto punë.

Neni 151

Të gjitha planet-skicat e gjelbërimit duhet të jenë të harmonizuara me planin e përgjithshëm të gjelbërimit të qytetit, respektivisht me konceptin e planit urbanistik për të cilin duhet të kujdeset: projektuesi, investuesi, dhe organi kompetent komunal. Ndërkaq, shënimet e nevojshme për harmonizimin e planeve të gjelbërimit i jep Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.

Neni 152

Para se të bëhet gjelbërimi i sipërfaqeve të parapara me këtë rregullore, shfrytëzuesit e tokës, janë të obliguar që të marrin leje për gjelbërim në organin kompetent të administratës komunale.

Neni 153

Shfrytëzuesi i sipërfaqeve është i obliguar që të punojë në bazë të kushteve të parapara në leje dhe për çdo ndryshim, i cili nuk është i paraparë në leje, duhet të njoftohet organin, i cili e ka lëshuar lejen.

Neni 154

Gjelbërimi i sipërfaqeve të ndërtimeve të reja duhet të parashihet me projekt mbi

ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve, në harmoni me planin urbanistik, duke e përcjellë dhe duke ushtruar kontroll profesional të organit kompetent të administratës komunale.

Neni 155

Projektet e ndërtimeve të reja në zonat urbanistike, në përputhje me planet rregulative, të cilat nuk i kanë edhe planet-skicat e tokës për gjelbërim, sipas kësaj rregulloreje, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lëshohet leje ndërtimi.

Neni 156

Punët në gjelbërimin e sipërfaqeve të tërsishme të lokacioneve përrreth objekteve të reja të ndërtuara, investuesi përkatësisht punëkryesi, janë të detyruar që t'i kryejnë para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe punëve tjera, ndërkaq, që komisioni për pranimin teknik, është i obliguar që njëkohësisht të bëjë edhe pranimin e punëve të gjelbërimit.

Neni 157

Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën ndërtimore të urbanizuar, pronari ose shfrytëzuesi do t'i shndërrojë në gjelbërim të sipërfaqeve, në pajtim me këtë rregullore, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e pranimin të shkresës zyrtare të organit kompetent komunal.

Neni 158

Në qoftë se shfrytëzuesi i tokës nuk e kryen gjelbërimin në afatin e caktuar, organi kompetent i administratës komunale do ta urdhërojë ndërmarrjen e cila merret me punë të tilla që ta kryej gjelbërimin, me shpenzimet e shfrytëzuesit, si dhe gjoba e paraparë.

Neni 159

Shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbëruara publike, jashtë destinimit të tyre, mund të bëhet vetëm në bazë të lejes së organit kompetent të administratës komunale.

Neni 160

Ndërmarrja të cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit, sipas marrëveshjes me komunën, është e obliguar që nëpër parqe, qendër, sheshe, rrugë e kthesa të gjelbëruara, të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të ulëseve (bankave) për pushim si dhe shportave për mbeturina të imta.

Neni 161

Vendosja e instalimeve nëntokësore në sipërfaqet e gjelbëruara, bëhet në distancë sa më të largët të mundshme nga fidanja e mbjellur, por me lejen paraprake të organit të administratës komunale për rrëmihje si dhe kthimi në gjendjen e mëparshme.

Neni 162

Ndërmarrja, të cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, nëse ndryshe nuk është paraparë me marrëveshje, është e obliguar:

- Që menjëher t'i largojë drunjët ose degët e dëmtuara ose të shkaputura për shkak të ndikimit të kushteve natyrore, atmosferike ose kushteve të tjera të pa parapara.
- Që barin e kositur si dhe materialin e mbetur nga puna ta largojë nga sipërfaqet e gjelbëruara publike ku është kryer puna.
- Që sipërfaqet e gjelbëruara t'i furnizojë me pleh artificial, natyral, compost, e mbeturina

të sharrës

- Që të mihë sipërfaqet e gjelbëruara ku janë mbjellur: fidane të reja, gjelbërim i ulët, lule etj.
- Që të prejë ose krasitë degët e rritura të drunjve, të cilat i pengojnë kabllot elektrike të telefonisë.
- Që të prejë degët, të cilat pengojnë dukshmërinë në komunikacion dhe dukshmërinë e shenjave të komunikacionit, në rrugët locale;
- Që të prejë degët që pengojnë lëvizjen e lirë të automjeteve në rrugë dhe këmbësorëve, në trotuar.
- Që të prejë degët, të cilat pengojnë lëvizjen e lirë të ujit në lumenj e përrocka, etj.

Neni 163

Dëmet e shkaktuara në sipërfaqe të gjelbëruara nga ana e personave juridikë dhe fizikë do të vlerësohet nga ana e komisionit, të cilin e emëron kryetari, sipas kërkesës së ndërmarrjes të cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit.

Neni 164

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbrimit është e obliguar që në vende të dukshme të vendosë pllakatat ose shenjat në të cilat janë të shënuara ndalesat ose vërejtjet në rastet e keqpërdorimit të hapsirave të gjelbruara publike.

Neni 165

Në sipërfaqet e gjelbëruara publike dhe parqe, ndalohe:

- Prerja, thyerja, nxjerrja, dëmtimi, i drunjëve, i fidaneve të posambjellura, si dhe gjelbërimit të ulët.
- Kositja me qëllim përvetësimi, shkelja dhe dëmtimi i qfardo lloji të barit, bimëve dhe luleve të ndryshme.
- Ngasja ose parkimi i automjeteve në sipërfaqet e gjelbëruara,
- Shkarkimi ose deponimi i çfardo materiali ndërtimor ose tjetër në sipërfaqe të gjelbëruar,
- Dëmtimi largimi ose djegia e ulëseve të ndryshme, shportave ose kontejnierëve, rekvizitave, reklamave, tabelave, shenjave, hidranteve, aleve për këmbësorë, rrethojave si dhe instalimeve të tjera të ndryshme,
- Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimit të tyre themelor ose kryerja e çfardo veprimtarie në to, pa lejen e posaqme,
- Vënia, varja, ose derdhja e çfardo materiali ose lënde, nëpër drunj dhe pjesë tjera të tyre,
- Lëvizja (ecja) ose vrapimi jashtë aleve të shënuara për këmbësorë,
- Qëndrimi, ulja ose shtrirja me qëllim dëmtimi të sipërfaqeve të gjelbëruara me lule,
- Lëshimi, derdhja e ujërave të zeza, ujërave fundrinore, fekalieve, dhe lëngjeve të ndryshme në sipërfaqet e gjelbëruara publike,
- Keqpërdorimi i ujërave në fontana ose kroje publike,
- Gjuetia e shtazëve ose shpezëve në këto zona,
- Vendosja e Lojrave, (Ringishpillit) Cirkut, Manifestimeve ose tubimeve të tjera pa lejen e posaqme të organit kompetent të administrates komunale,
- Shfrytëzimi i hapësirave të gjelbëruara për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake,
- Ndezja e zjarreve për qëllime: grilli, pushimi, festimi, ose argëtimi, përveç në zonat e lejuara,
- Hudhja e mbeturinave të ndryshme,
- Rrëmihja ose gropimi i sipërfaqes së gjelbëruar pa leje të posaqme,

14. KUSHTET MINIMALE PËR PASTËRTI

Neni 166

Të gjithë qytetarët, pronarët e ndërtesave familjare të banimit dhe të tjera, si dhe pronarët e lokaleve afariste në fshatra, kanë për detyrë të mbajnë pastërtinë përrreth objekteve të tyre dhe rrugëve publike afër tyre.

Neni 167

Administratori i bashkësisë, përkatësisht fshatit, mund të kërkojë nga pronarët që brenda afatit të caktuar ta pastrojë dhe ta mirëmbajë hapësirën rreth objektit të vet si duhet, në qoftë se kjo nuk kryhet dhe mirëmbahet, administrator duhet të njoftojë dhe të kërkojë intervenimin e inspektorit komunal.

Neni 168

Pronarët e lokaleve banesore dhe afariste si dhe objekteve të tjera industriale edhe nëpër fshatra duhet të kenë të ndërtuar njëjën sanitare sipas dispozitave higjieno-sanitare, largë nga objektet e ujit (puset dhe burimet) më së paku 30 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, ndërsa nga ndërtesa tjetër e banimit dhe rruga së paku 20 metra.

Neni 169

Është e ndaluar hudhja e çfarëdo lloji të mbeturinave, në hapësirat publike dhe fusha përveç në mjetet e destinuar siç janë kontejnerët dhe mjete të tjera për hudhje të mbeturinave si dhe bartja ose grumbullimi i mbeturinave në deponi të caktuar të mbeturinave.

Neni 170

Është e ndaluar hudhja e mbeturinave të kafshëve (plehërat), në fusha, hapësira publike, përrreth rrugës, rreth lumenjve dhe hapësira të tjera të pyjeve ose hapësira të braktitura, ndërkaq, posaqërisht është e ndaluar hudhja e mbeturinave rreth objekteve të ujësjellësit, dhe objekteve të tjera të ujit. Alternativë për zgjidhjen e problemit për hudhjen e plehërave të kafshëve është skaji (qoshi) i pasurisë të paluajtshme (arës), aty ku nuk i dëmton të tjerët dhe më tutje shpërndarja e tij.

Neni 171

Ndalohet hudhja e kafshëve dhe shpezëve të ngordhura si dhe mbeturinave tjera të tyre siç janë (eshtërat ose pjesë të tjera të pashfrytëzuara të kafshëve ose shpezëve) në hapësirat publike.

Neni 172

Ndalohet therrja e kafshëve dhe shpezëve jashtë therrtores në rrugë, trotuare, sheshe, dhe sipërfaqe të tjera publike, përveç rasteve me leje të vecentë nga organi kompetent.

Neni 173

Ndalohet lëshimi i lëvizjes së lirë të kafshëve ose të shpezëve shtëpiake pa përcjellje të pronarëve të moshës madhore nëpër rrugë ose hapësira publike, të cilat do të mund të shkaktonin pengesa ose rrezik në komunikacion ose shkaktojnë dëme materiale personave tjerë.

Neni 174

Është e ndaluar vendosja e ushqimit të kafshëve, druve, gurëve, zhavorrit, materialit

ndërtimor, etj. përrreth rrugës në fusha dhe hapësira të tjera publike, këto mund të vendosen vetëm brenda pronave private.

Neni 175

Është i ndaluar ndërtimi i çfardo muri, në hapësirat publike ose pasuri të pa luajtshme e cila nuk është pronë e tijë, rrethimi me tel, me dru, me gurë ose material tjetër, hapja e kanaleve ose vijave të ndryshme në një parcelë ose sipërfaqe të caktuar, mbjellja e fidaneve rreth një parcele për rreth lumit ose vende të tjera me qëllim të përkufizimit të një sipërfaqe ose pjese të caktuar të tokës.

Si dhe është paraparë gjoha dhe këthimi në gjendjen e mëparshme.

15. GROPIMI, RRËMIHJA, PRERJA OSE SHPUARJA E SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Neni 176

Është i ndaluar çdo gropim, prerje, rrëmihe ose shpuarje në rrugë, trotuar ose sipërfaqe tjetër publike, pa lejen e organit kompetent të administratës komunale.

Neni 177

Gropimi ose shpuarja e sipërfaqeve publike mund të bëhet (me leje) për vendosjen e instalimeve mbitokësore dhe nëntokësore të objekteve për mirëmbajtjen e kanalizimit, ujësjellësit, nxemjes qerndrore, energjisë elektrike, telefonit e të tjera.

Neni 178

Lejen për gropimin, rrëmihe ose shpuarjen e sipërfaqeve publike (trotuarit, rrugëve etj.) e lëshon organi kompetent komunal. Në leje duhet të caktohen mënyra dhe kushtet për kryerjen e punëve, si vijon: a) Sasia ose thellësia e shtresës e cila duhet të rrëmihet, b) Vendi dhe qëllimi i kryerjes së punëve, c) Mënyra e sigurimit të kalimtarëve dhe automjeteve, d) Koha brenda së cilës duhet të fillojnë dhe mbarojnë punët si dhe mënyra e rregullimit të sipërfaqeve publike pas punëve të kryera (këthimi në gjendjen e mëparshme),etj.

Neni 179

Disa punë të gropimit të sipërfaqeve publike janë urgjente dhe duhet të kryhen brenda afatit dhe kushteve të caktuara në leje, ndërsa kryesi i punëve ka për detyrë që para gropimit të sipërfaqeve publike të siguroj vendpunimin sipas lejes së lëshuar .Pas kryerjes së punëve në sipërfaqet publike, investitori përkatësisht kryesi i punëve, ka për detyrë që sipërfaqen ta rregullojë siç ka qenë më parë dhe ta mirëmbajë në afat prej 6 muajsh (përveç në rastet nëse me kontratë është paraparë ndryshe), nga dita e kryerjes së punëve, ndërkaq, nëse investitori përkatësisht kryesi i punëve pas kryerjes së punëve nuk e rregullon sipërfaqen publike, siç ka qenë më parë, organi i administratës komunale, kompetente për lëshuarjen e lejes për kryerjen e punëve, mund të urdhërojë që këtë ta kryejë ndërmarrja tjetër, me shpenzimet të investitorit ose punëkryesit të mëparshëm.

Neni 180

Në qoftë se shkaktohen prishje ose dëmtime në objektet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, ose objekte të cilat duhet të rregullohen menjëherë për shkak të mundësisë së shkakimit të dëmeve më të mëdha materiale, ose për shkak të rrezikut për jetën dhe

shëndetin e njerëzve, ndërmarrja ose personat tjerë juridikë, të cilët mirëmbajnë këto instalime, kanë mundësi që pa leje të organit kompetent të gropojnë sipërfaqet publike për rregullimin, ose evitimin e prishjes në instalim, në qoftë se leja, për shkaqe objektive të rrethanave, nuk ka mundur të merret menjëherë.

Neni 181

Ndërmarrjet ose personat tjerë juridikë, të cilët punojnë pa leje, sipas nenit paraprak 180, duhet menjëher, pas ndërprerjes së rrethanave objektive, e më së largu brenda afatit prej 3 ditësh, t'i drejtohet organit komunal kompetent të ndërtimit, për marrjen e mëvonshme të pëlqimit për kryerjen e punëve dhe caktimin e mënyrës së rregullimit të rrugës, trotuarit ose sipërfaqeve tjera publike.

Neni 182

Nuk mund të lëshohet leje për rrëmihje të sipërfaqeve publike, në periudhën kohore prej 1 dhjetorit deri më 28 shkurt, me përjashtim të nevojave urgjente.

16. RRETHOJAT

Neni 183

Të gjitha rrethojat në qendër të urbanizuar, pa marrë parasysh pronësinë, ndërtohen vetëm në bazë të lejes paraprake të organit kompetent të administratës komunale.

Neni 184

Të gjitha llojet e rrethojave duhet të ndërtohen në pajtim me dispozitat pozitive ligjore, në përputhje me kushtet e lejes për ndërtim si dhe në harmoni me pamjen estetike të qendrës së urbanizuar.

Neni 185

Çdo pronar i rrethojave të vjetëruara, që paraqesin pengesa ose e shëmtojnë pamjen e qytetit, është i obliguar që t'i ndërrojë ose t'i mirëmbajë ato në harmoni me pamjen e qytetit.

Neni 186

Përveç rrethojave prej: murit, betonit, metalit, drurit, pronarët ose shfrytëzuesit mund të bëjnë edhe rrethoja të ashtuquajtura të gjelbërta, të cilat duhet të mirëmbahen, prehen (krasiten), sipas nevojës dhe shijes, rrethojat e gjelbërta nuk është e lejuar që të pengojnë me degët e tyre qarkullimin e këmbësorëve dhe dukshmërinë e shenjave të komunikacionit.

Neni 187

Është e ndaluar ngjyrosja, mbishkrimet ose vizatimi në rrethoja ose objekte të tjera me të cilat nxiten urrejtje të ndryshme, ose prishet estetika e vendbanimit.

17. OBJEKTET PUBLIKE

Neni 188

Objekte publike janë të gjitha objektet nëntoksore dhe mbitokësore në të cilat qytetari ka të drejtë që të kalojë, pushojë ose të ushtrojë ndonjë të drejtë të tij, të barabart me qytetarët e tjerë të përcaktuar me ligj dhe rregullore. Ato mund të jenë: komuna dhe objektet e institucioneve, shkollat, foshnjoret, objektet shëndetësore, objektet e postës dhe të telefonisë, objektet e KEK-ut, objektet e kultit fetar, varrezat, objektet përkujtimore, stacionet e mjeteve transportuese për udhëtarë, rrugët, trotualet, urat, tabelat për shpallje, panot, reklamat, parkingjet, sheshet, shenjat e komunikacionit, ndriçimi publik, tregjet, objektet sportive, pushimoret, parqet dhe hapësirat publike të gjelbëruara, objektet e kanalizimit dhe ujësjellësit, objektet tregtare, muzetë, teatrot, sallat e filmave, objektet e panairëve etj.

Neni 189

Është i ndaluar shfrytëzimi i të gjitha llojeve të të mirave dhe i çfarëdo forme fitimi nga objektet publike pa leje të përgjegjësit ose organit kompetent të administratës komunale.

Neni 190

Objektet publike mirëmbahen nga menaxhuesi i autorizuar, pronarët ose , shfrytëzuesit e objekteve publike.

Neni 191

Është i ndaluar keqpërdorimi i objekteve publike ose përdorimi pa leje në kuptimin negativ të këtyre fjalëve: thyerja, shtrembërimi, mbyllja, gërrvishja, shpuarja, prerja, ngjyrosja, ndërtimi, mbindërtimi, rrënimi, zhvendosja, zhytja, vjedhja, si dhe pengesat për lëvizjen e lirë të automjeteve dhe qytetarëve.

Neni 192

Të gjitha ndërtesat publike, objektet hoteliere, autokampe dhe autokino, objektet për mbajtjen e shfaqjeve ligjërata dhe filmave, shkolla të ndryshme, Klube e shoqata, stacionet për transportin e udhëtarëve, terrenet sportive dhe pushimore tregjet si dhe objekte të tjera publike, duhet domosdo të jenë të pajisura me një ose më shumë nyje sanitare për meshkuj për femra, dhe të kenë qasje të lirë personat me aftësi të kufizuar.

Neni 193

Mirëmbajtja e nyjeve sanitare në objektet publike është detyrë e: pronarit, shfrytëzuesit, ose menaxhuesit me objekte publike. Nyjet sanitare duhen të ngjyrosen, pastrohen rregullisht ndërsa dezinfektimi i tyre duhet të bëhet së paku një herë në javë.

18. NDRIÇIMI PUBLIK

Neni 194

Për menaxhimin dhe mirëmbajtjen ndriçimit publik të rrugëve, trotuarëve dhe parqeve, kujdeset ndërmarrja, të cilës i janë besuar kryerja e punëve e cila ka fituar tenderin sipas shpalljes.

Neni 195

Të gjitha rrugët (kryesore dhe sekondare) si dhe rrugët me rendësi më të vogël në të cilat

është vendosur ndriçimi publik, duhet të jenë të ndriçuara natën dhe në errësi me ndriçim optimal.

Neni 196

Ndriçimi optimal i rrugëve mund të reduktohet pas ores 24 h në mënyrë automatike me përqindje të uljes së dritës, ose në mënyrë selektive, (një po një jo ose një po dy jo etj) deri në mëngjes.

Neni 197

Shtyllat e ndriçimit publik duhet të jenë stabile në pozitë vertikale në mënyrë që të mos cenojnë sigurinë e kalimtarëve dhe të pasurisë, shtyllat duhet të jenë të mbrojtura nga aspekti i elektricitetit, përkatësisht kapakët e siguresave duhet të jenë në gjendje të rregullt për mbrojtje nga lagështija në çdo kohë.

Neni 198

Menaxhuesi i ndriçimit publik duhet të kujdeset që shtyllat e dëmtuara të ndriçimit të rregullohen sa më pare, e më së largu 6 ditë nga dita e prishjes, të kujdeset për ndërrimin e poqave të shpenzuara si dhe eliminimin e defekteve tjera. Ngjyrosja gjenerale e të gjitha shtyllave të sistemit të ndriçimit publik është paraparë të bëhet së paku një herë në 3 vjetë. Përveq rasteve të riparimit të dëmtimeve të një apo më shumë shtyllave.

Neni 199

Është e ndaluar dëmtimi, gërvishtja, ngjyrosja ose shfrytëzimi për nevoja të ndryshme, (Vendosje të reklamave, shenjave, udhëtreguesve etj) pa leje të organit kompetent të administratës komunale.

19. TREGJET

Neni 200

Mbikqyrjen dhe menaxhimin me tregjet në komunën e Kaçanikut e ushtron Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 201

Tregjet në kuptim të kësaj rregullore janë vende të hapura ose të mbuluara, të caktuara me vendim të Kuvendit Komunal, në të cilin kryhen shitblerje të mallrave në ditën e caktuar (e Premte). Në këto tregje mund të kryhen edhe shitblerje për ç'do ditë, nëse nuk është përcaktuar komuna për ndonjë vend tjetër për treg ditor, përveç ditëve e shtunë dhe e dielë.

Neni 202

Shitësit janë të obliguar që të paguajn tariffën e ngarkesës për shfrytëzimin e lokacionit të tregut të paraparë sipas rregullores për tregjet. Për të gjithë ata të cilët nuk kanë paguar tariffën është paraparë denimi me gjobë.

Neni 203

Sipas kësaj rregulloreje në ditën e tregut nuk është e lejuar shitblerja e mallrave jashtë rrethojave të tregjeve, ose pikave të parapara me vendim të organit kompetent.

Neni 204

Në raste të veçanta mund të lejohet nga organi kompetent i administratës komunale që shitblerja e mallrave të kryhet në vendin (Lokacionin) e caktuar, ose shitblerje me mjet

lëvizës, me leje të posaqme dhe nën kushtet të caktuara.

- Organizimi i panairëve ose tregjeve fushore apo të mbyllura,
- Për tregje të organizuara të automjeteve,
- Për shitblerje sezonale në zona të caktuara,
- Lidhur me kërkesa të paparashikuara të cilat kanë për qëllim plotësimin e nevojave specifike të një grupi të madh të qytetarëve,
- Shitblerje me mjete lëvizëse, nën kushte të caktuara,
- Shitblerje në rastet e organizimit të manifestimeve, koncerteve, tubimeve të ndryshme, pushimeve të organizuara, përkujtimeve etj.

Neni 205

Mirëmbajtjen dhe pastrimin e tregjeve e kryen ndërrmarrja së cilës i janë besuar kryerja e këtyre punëve.

Neni 206

Menaxhuesi i trexheve duhet të kujdeset për të siguruar kushte sa më të favorshme për kryerjen e afarizmit të shitblerjes në ditën e tregut, duke paisur tregun me: Tezga për shitblerje, Mbulojë për pjesët e tregut të bylmetit, Ujë higjienik, Pastëruti, Nyje sanitare, Kushtet minimale për tregun e kafshëve, hapsirë të mjaftueshme, shërbime administrative, energji elektrike etj.

Neni 207

Nuk është i lejuar parkimi i automjeteve në hapsirën e tregut të mallrave (Plaqkave).

Neni 208

Nuk është e lejuar shkarkimi i mallrave, plaqkave, materialit ndërtimor etj. në lokacionet e tregjeve me qëllim që aty të qëndrojnë dy ose ma tepër ditë, përveq në rastet kur organi kompetent i administratës komunale e ka lejuar një gjë të tillë me leje të posaqme.

Neni 209

Nuk është i lejuar zhvillimi i asnjë lloj aktiviteti në lokacionet e tregjeve pa leje nga organi kompetent i administratës komunale.

Neni 210

Tregtarët, shfrytëzues të hapësirës së destinuar për treg janë të obliguar që të kryejnë pagesën e tarifës për shfrytëzimin e tregut nga tregëtarët, sipas vendimit të kuvendit komunal mbi çmimoren e tarifës së ngarkesave për tregje.

Neni 211

Inspektorët komunalë janë të obliguar që të bëjnë kontrollin dhe verifikimin e pagesave.

Neni 212

Sipas kësaj rregulloreje caktimin e vendeve të përkohshme (një ditore) për shitje e bëjnë punëtorët e tregut duke u bazuar në numrat e vendeve për shitje dhe ndihmën e inspektorëve, ndërkaq, caktimin, rezervimet dhe pagesat mujore ose vjetore kryhen në zyret e Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 213

Kjo rregullore lejon ndryshimin e vendeve të shitjes për tregëtarët, sipas disa kushteve.

- Kategoria e parë: Shitësit, të cilët më herët kanë paguar tarifën rregullisht, do të favorizohen me vende më të mira për shitje.
- Kategoria e dytë: Do të favorizohen edhe shitësit të cilët asnjëherë nuk kanë paraqitur probleme për vendosjen e tyre në vendshitje.
- Kategoria e tretë: Do të favorizohen edhe shitësit e rregullt në krahasim me shitësit periodikë si dhe shitësit më të vjetër e të cilët nuk kanë paraqitur probleme.
- Kategoria e katërt: Shitësit, të cilët nuk kanë uzurpuar hapësirë për shitje, që kanë qëndruar në vijën e caktuar dhe ata të cilët kanë bashkëpunuar me drejtuesit e tregut për të pasur rregull në treg.

Neni 214

Drejtorja për Shërbime Publike është e obliguar që të organizojë dhe kordinojë punët organizative dhe teknike, nëpërmjet punëtorëve të saj të tregut, ndërkaq implementimin e rregullores sa i përket rregullave të tregut, obligohet ta kryejë shërbimi i inspektoratit, për funksionimin sa më të mirë të tregjeve.

20. SHITBLERJET AMBULANTE

Neni 215

Me shitblerjet ambulante, në kuptimin e kësaj rregulloreje, nënkuptojmë, shitblerjet që kryhen në, rrugë, trotuar, ose hapësira tjera publike, ku shitësit e këtyre mallrave janë ose mund të jenë në lëvizje. Shitësit ambulante, mallin e tyre e vendosin në objekte të vogla, në objekte lëvizëse ose e shesin në dorë duke pasë mundësinë e lëvizjes nga një vend në tjetrin.

Neni 216

Shitblerje ambulante, mund të kryhet vetëm me leje të posaqme.

Neni 217

Lejen për shitblerje ambulante e lëshonë Drejtorja për Shërbime Publike, pasi të plotësohen kushtet e parapara.

Kushtet në të cilat mund të lëshohet leja për shitblerje ambulante janë:

- Leje për shitblerje ambulante mund të lëshohet vetëm në rastet para festave.
- Nuk mund të lëshohet leje për shitblerje ambulante për gjërat ushqimore, për ruajtjen e të cilave nevojiten temperaturat më të ulëta se 7 gradë celsius.
- Nuk mund të lëshohet leje e përhershme ose me afat më të gjatë se një muaj.
- Pagesa është paraparë me rregullore të vecantë.
- Me lëshimin e lejes nuk marret për obligim sigurimi i lokacionit për shitje
- Shitblerje ambulante (me leje të lëshuar) mund të kryhet edhe në trotuaret e këmbësorëve me gjërësi të mjaftueshme, në qoftë se hapësira tjetër e mbetur për lëvizje të këmbësorëve nuk është më e vogël se 160 cm.
- Shitblerje ambulante nuk mund të kryhet para lokaleve afariste ku mund të pengohet kryerja e veprimtarisë, përveç në rastet me pëlqimin e menaxhuesit të lokalit afarist.

21. VERANDAT

Neni 218

Me termin Veranda, në kuptimin e kësaj rregulloreje nënkuptojmë: Vendi i caktuar, ose i përkufizuar para lokaleve afariste hoteliere, kafiterive, ëmbëltoreve ose të tjera, i destinuar për mysafirë për të pushuar, pirë ose ngrënë, i lejuar për destinim të tillë nga organi kompetent i administratës komunale, për kohë të caktuar gjatë sezonit veror.

Neni 219

Është i ndaluar rregullimi ose shfrytëzimi i sipërfaqeve publike për veranda, pa leje të posaqme të drejtorisë për Shërbime Publike të Kuvendit Komunal në Kaçanik.

Neni 220

Kërkesa për leje për shfrytëzimin e hapësirave publike për veranda, mund të bëhet vetëm për ato lokacione që kanë gjatësi dhe gjërësi të mjaftueshme para lokaleve të tyre, ose në hapësira tjera ku nuk pengohet qarkullimi i lirë i njerëzve dhe automjeteve ose nuk krijohen pengesa të tjera të natyrave të ndryshme.

Neni 221

Lokacioni i verandave mund të jetë me mbulojë, por jo edhe i ankeruar, me qëllim që gjatë sezonit dimëror, duhet të largohet. Në lokacionet e verandave nuk është i lejuar ndërtimi i çfardo lloji të mureve me qëllim të përkufizimit të hapësirës së verandave. Verandat mund të përkufizohen me materiale të ndryshme lëvizëse, lartësia e të cilave nuk tejkalon 0.80m.

Neni 222

Për veranda mund të shfrytëzohen hapsirat ose lokacionet para objektit të lokalit të vet afarist, nën ose mbi terasa ose pllaka të objekteve afariste e të cilat nuk qëndrojnë në kundërshtim me nenet paraprake të këtij kapitulli, të lejuar me leje nga organi kompetent i administratës komunale.

Neni 223

Orari i punës dhe i shërbimit në veranda është i njëjtë me orarin e punës të lokalit afarist hotelier, që punohet për brenda, ose në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal për orarin e punës të lokaleve afariste në territorin e Komunës.

Neni 224

Pagesa për shfrytëzimin e hapësirës publike për Veranda paguhet për metër katror, sipas rregullores komunale për tarifa dhe ngarkesa. Sezoni veror sipas kësaj rregulloreje konsiderohet nga data 01/04 deri më 30/09 të vitit vijues kalendarik.

Neni 225

Në rastet kur pala dëshiron të bëjë kërkesë për shfrytëzimin e hapsirave publike për veranda para sezonit veror, pagesa i llogaritet bashkarisht për muajt para sezonit si dhe gjatë sezonit veror. Ndërkaq, për vazhdimin e shfrytëzimit të hapësirave publike për veranda edhe për një ose ma shumë muaj, duhet që të bëhet kërkesë e re, para se të përfundojë sezoni veror dhe pagesa llogaritet për muajt për të cilët është kërkuar vazhdimi i lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike për veranda.

Neni 226

Me kontratë të veçantë për shfrytëzuesin e hapësirave publike për veranda do të të parashihen kushtet e veçanta sipas të cilat pala mund ta shfrytëzojë hapësirën publike për veranda, duke patur parasysh vendin dhe secilin rast veç e veç si dhe duke zbatuar kushtet e parapara me këtë rregullore.

Neni 227

Mbikqyrjen për respektimin e neneve të kësaj rregulloreje, mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave publike për veranda, e kryen Drejtoria për Inspektorat. Në rastet e keqpërdorimit ose kur nuk shfrytëzohet hapësira sipas lejes së lëshuar, është paeparë gjoba.

22. FIRMAT DHE REKLAMAT

Neni 228

Firmat, në kuptimin e kësaj rregulloreje, nënkuptohen mbishkrimet e emërtimit të firmave, bizneseve, kompanive, institucioneve, shoqatave etj, të cilat mund të jenë në forma të ndryshme.

Neni 229

Për vendosjen e firmave, pronarët nuk janë të obliguar të paguajn tarifa, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e bizneseve të tyre.

Neni 230

Pronarët e bizneseve janë të obliguar që për vendosjen e firmës të marrin leje në Drejtorinë përkatëse. Me leje do të përcaktohen: kushtet, mënyra, madhësia, kohëzgjatja dhe vendi i vendosjes së firmës etj.

Neni 231

Firmat mund të vendosen në objektin afarist në pozitën horizontale ose vertikale, me ndriçim dhe pa ndriçim, mund të vendoset përpara lokalit ose anash, me kornizë dhe pa të, secili në pjesën e vet të lokalit, duke respektuar ligjin dhe rregullat e kësaj rregulloreje. (preferohet, vendosja mbi hyrjen në objektin afarist).

Neni 232

Në qoftë se pronari ose shfrytëzuesi i lokalit afarist dëshiron që firmën e tij ta vendosë në muret ose në hapësirën e lokalit tjetër, duhet që paraprakisht të ketë pëlqimin me shkrim të pronarit të objektit ose hapësirës tjetër.

Neni 233

Reklamat me kornizë (shtëpizë): Reklamat me kornizë, në kuptimin e kësaj rregulloreje, nënkuptohen reklammat që kanë konstruksionin e kornizës prej metali ose materialit tjetër, e cila për kah ndërtimi i saj mundëson hapjen dhe mbylljen e saj për vendosjen, kohë pas kohe të reklamave prej letre, folie, stofi ose materiali tjetër. Në brendinë e kornizës mund të jetë i instaluar edhe sistemi i ndriçimit të saj.

Neni 234

Menaxhuesi i këtyre reklamave është i obliguar që të paguajë tarifën sipas rregullores për pagesën e tarifave, në këto raste:

a) Në rastet kur reklama me kornizë është vendosur në pasuritë e paluajtshme publike dhe private.

b) Në rastet kur reklama me kornizë vendoset në muret e objekteve të banimit privat ose kolektiv, si dhe në objekte të tjera publike ose private.

c) Nuk janë të obliguar të paguajn tarifën pronarët e reklamave me kornizë, të cilët i kanë vendosur reklamat vetëm në oborrin e rrethuar ose përkufizuar ku zhvillohet biznesi, ose në objektin e vet afarist dhe nëqoftëse reklama me kornizë përdoret vetëm për reklamimin, i cili ka të bëjë direkt me veprimtarinë e tij. Për të gjitha rastet të cilat bien në kundërshtim me pikat a, b, c, është paraparë gjoha.

Neni 235

Pagesën e tarifës për reklamat me kornizë, të paraparë me këtë rregullore, është i obliguar ta paguajë ndërtuesi përkatësisht menaxhuesi i reklamës me kornizë, për periudhën kohore (minimumi një vit). Pagesa për vazhdim do të bëhet 15 ditë përpara, për sa kohë që do të arrihet kontrata, (minimumi pesë vite). Reklama me kornizë do të largohet menjëherë pas kalimit të afatit për të cilin është bërë kontrata, në qoftë se nuk bëhet kërkesa për vazhdimin e kontratës, 15 ditë përpara kalimit të afatit. Në tekstin e kontratës, përveç të tjerave, parashtruesi i kërkesës do të njoftohet se: obligohet që të paguajë edhe për kohëzgjatjen e qëndrimit të reklamës me kornizë pas kalimit të afatit nëse nuk e largon sipas afatit të kontratës. Lejen për ndërtimin e reklamave me kornizë, sipas kërkesës së pales, e lëshon Drejtoria përkatëse, duke respektuar, ligjin, rregullat urbanistike dhe të komunikacionit, si dhe këtë rregullore. Drejtoria për shërbime publike lëshon pëlqimin, nënshkruan kontratën dhe përcjellë afatet e pagesës.

Neni 236

Menaxhuesi i shtëpizave të reklamave është i obliguar që këto t'i mbajë të pastërta, në përputhje me estetikën e qytetit.

Neni 237

Reklamat me ndriçim të fortë si dhe reklamat vezulluese nuk mund të vendosen në vendet ku e zvoglojnë dukshmërinë e lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorëve.

Neni 238

Është e ndaluar vendosja e reklamave (me kornizë dhe pa kornizë), pa leje të posaqme nga organi kompetent i administrates komunale.

Neni 239

Reklamat pa kornizë (shtëpizë), në kuptimin e kësaj rregulloreje, nënkuptohen të gjitha: Panot, Posterat, , Folitë, Stofi, Kartonat, Dërrasat, Muret ose material tjetër në të cilin janë të shkruar, punuar, ose fotografuar, mbishkrime ose fotografi, të cilat vendosen në vende publike dhe kanë për qëllim reklamimin e një malli, personaliteti, shërbimi, veprimtarie ose që tregojnë një qëllim të caktuar. *(Nga kjo përjashtohen reklamat dhe muralet që nuk kanë për qëllim reklamimin).*

Neni 240

Reklamat pa kornizë janë të karakterit të përkohshëm dhe lejen për vendosjen e tyre e lëshon Drejtoria për Shërbime Publike duke u bazuar në ligj dhe këtë rregullore.

Neni 241

Është e ndaluar vendosja e reklamave pa kornizë në hapsirat publike. Mbikqyrjen e vendosjes sipas lejes, si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të reklamave pa kornizë, e kontrollon inspektori për shërnime publike.

Neni 242

Pas kalimit të afatit të pagesës, poseduesi i lejes për vendosje të reklamave është i obliguar që t'i largojë reklamat nga vendi ku janë vendosur.

Në leje përpos kushteve tjera, do të saktësohet se në rastet kur poseduesi i lejes nuk i largon reklamat, maximumi dhjetë ditë pas kalimit të afatit, sipas raportit të inspektorit, komuna do të angazhojë një kompani për heqjen e tyre me shpenzime që do të ngarkohet poseduesi i lejes.

Neni 243

Në përmbajtjen e parashtruesit të kërkesës do të plotësohen, përveç të tjerash, edhe të dhënat mbi: përmbajtjen e reklamës, sasia, teksti i mbishkrimit, madhësia në meter katror, kohëzgjatja dhe vendi ku duhen të vendosen reklamat.

Neni 244

Vendosja e Firmave, Reklamave, Vitrinave ose e stabilimenteve të tjera, të përforcuara në muret e jashtme të objekteve afariste ose objekte të tjera, me qëllim të mbrojtjes nga dielli, shiu ose bora, duhet të bëhet mbi 4 m. lartësi nga niveli i sipërfaqes ku lëvizin automjetet ndërsa 2.50 m. nga niveli i sipërfaqes ku lëvizin këmbësorët.

Neni 245

Pagesa për Shitje sezonale, Vitrina, Reklamat me kornizë, Reklamat pa kornizë, Veranda, Vendosja e përkohshme e lojrave, Vendosja e kontejnerëve për mbeturina ricikluese, do të kryhet sipas rregullores mbi tarifën e pagesave komunal

23. VITRINAT

Neni 246

Me Vitrina, në kuptimin e kësaj rregulloreje, kuptojmë hapësirën e posaqme në xhama, e caktuar në pjesën e përparme të objektit afarist ose Vitrina të veçanta të ndërtuar veçmas me konstrukcion metali ose tjetër dhe të tejdukshëm. Kjo hapësirë shërben për vendosjen e mallërave me qëllim të reklamimit të tyre.

Neni 247

Lejen për ndërtimin e Vitrinave të reja, të veçanta ose hapjen e vitrinave në objektet, të cilat nuk kanë pasë leje për destinim të tillë, e bën Drejtoria për planifikim, zhvillim rindërtim, dhe urbanizëm, në përputhje me kushtet urbanistike, lejen ndërtimore dhe këtë rregullore.

Neni 248

Me leje ndërtimi të objekteve të reja afariste duhet të jetë e inkorporuar edhe leja për shfrytëzimin e të drejtës për reklamimin e mallërave në vitrina të objektit të ri afarist.

Neni 249

Sipas kësaj rregulloreje, dallojmë dy lloje të vitrinave:

1. Vitrinat e veçanta, që shërbejnë për reklamimin e mallërave për të cilat duhet të paguhet tarifa sipas tabelës mbi tarifatat për vitrina, të kësaj rregulloreje, në këto raste:
 - a) Në rastet kur, Vitrina është vendosur në pasuritë e pa luajtshme publike dhe private.
 - b) Në rastet kur Vitrina vendoset në muret e objekteve të banimit privat ose kolektiv si dhe në objekte të tjera publike ose private.
2. Vitrinat, për të cilat pronari ose shfrytëzuesi nuk është i obliguar të paguajë tarifa:
 - c) Nuk janë të obliguar të paguajnë tarifën pronarët e Vitrinave të cilët i kanë vendosur Vitrinat në oborrin e rrethuar ose përkufizuar ku zhvillohet biznesi ose në objektin e vetë afarist.
 - d) Në qoftë se vitrina përdoret vetëm për reklamimin, i cili ka të bëjë, direkt me veprimtarinë e tij.
Për të gjitha rastet, të cilat bien në kundërshtim me pikat a, b, c, d, është paraparë gjoba.

Neni 250

Dallimi në mes të Vitrinave dhe Reklamave me kornizë, qëndron nëse:

- Në brendinë e vitrinave vendosen: mallra, ambalazhe, punime, etj. me qëllim që të reklamohen
- Në brendinë e reklamave me kornizë vendosen: postera, dhe punime tjera në letër, folie, pëlhurë etj., me qëllim të reklamimit të tyre.

Neni 251

Shfrytëzuesit janë të obliguar që të mirëmbajnë pastërtinë e vitrinave si dhe të rregullojnë brendinë e tyre në përputhje me interesat afariste të tyre dhe pamjen sa më të bukur nga qendra e qytetit.

Neni 252

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste dhe vitrinave në qytet dhe vendbanime të tjera, nëpër vitrinat e tyre mund të vendosin pjesë të reklamimeve të mallërave, ambalazheve, punimeve, artikujve si dhe objekteve të tjera të ndryshme të tij ose të ndërmarrjeve me të cilat shfrytëzuesi është në lidhje afariste.

Neni 253

Përveç reklamimit të mallrave , shfrytëzuesi i vitrinave në objektet afariste është i obliguar të vendosë edhe orarin e punës të lokalit afarist, në një vend të dukshëm.

Neni 254

Në rastet e kryerjes së punimeve: renovimi, adaptimi, regjistrimi, ndërrimi të mallërave reklamuese, liritimit ose braktisjes së objektit afarist, në vitrina duhet të mbyllet pamja për kalimtarët, nga ana e brendshme e vitrinave.

Neni 255

Reklamimi i mallërave në vitrina duhet të bëhet në përputhje me zhvillimin e trendeve ekonomike, kulturore, pamjes sa më të bukur të qytetit dhe trendeve të modës, në mallërat e reklamuar mund të ketë edhe çmimet e artikujve.

Neni 256

Nuk mund të vendosen në vitrina ose të reklamohen mallëra, artikuj, objekte, ose reklama të ndryshme, të cilat janë në kundërshtim me moralin, kulturën , vlerat njerëzore, kombëtare, fetare, racore ose artikuj, të cilët për nga pamja e tyre mund të nxisin urrejtje të natyrave të ndryshme si dhe reklama, të cilat për nga pamja e tyre e shëmtojnë pamjen e rrethit.

24. TABELAT E SHPALLJEVE

Neni 257

Me Tabelat e shpalljeve, në kuptimin e kësaj rregulloreje, nënkuptohen konstrukcionet nga druri, metali, plastika etj. të ndërtuara në formë të kornizës (shtëpizës) me xham të tejdukshëm që nevojitet vetëm për vendosje të: Lajmërimeve, Shpalljeve, Njoftimeve, Tenderëve, Ofertave dhe Konkurseve, mund të jetë i instaluar edhe sistemi i ndriçimit të saj. Menaxhuesi i tyre është i obliguar që ta mirëmbajë dhe pastrojë në përputhje me estetikën e qytetit. Për keqpërdorim ose për përdorime të tjera, është paraparë gjoba.

Neni 258

Për ndërtimin e Tabelave të shpalljeve merret leje e veçantë nga Drejtoria kompetente me kërkesën e palës dhe pasi të jenë plotësuar kushtet e parapara.

Neni 259

Kushtet për ndërtimin përkatësisht vendosjen e tabelës së shpalljeve janë: Bashkë me kërkesën bashkangjitet edhe skica ose projekti me përshkrimet teknike, i cili përmban shënimet mbi madhësinë, vendin ku do të vendoset, periudhën kohore etj. Për tabelat e shpalljeve nuk është paraparë pagesë e ndonjë tarife.

Neni 260

Tabelat e shpalljeve nuk mund të përdoren për vendosje të reklamave ose për qëllime të tjera .

Neni 261

Është e ndaluar vendosja e të gjitha llojeve të Shpalljeve, Njoftimeve, Lajmërimeve, Pllakatave, Posterave, e të ngjajshme nëpër mure, shtylla, objekte të ndryshme, shenja komunikacioni, fasada, objekte elektrike, telefonike, etj. Gjithashtu është e ndaluar shkruarja ose vizatimi nëpër mure dhe objekte të tjera publike dhe private.

25. AGREGATËT

Neni 262

Me aggregate, në kuptimin e kësaj rregulloreje nënkuptohen gjeneratorët të ndryshëm, të cilët qytetarët i përdorin për furnizimin (prodhimin) me energji elektrike për ekonomi familjare, biznese, institucione, shoqata ose grupime të tjera të ndryshme.

Neni 263

Agregatët mund të përdoren për nevoja të qytetarëve dhe në rastet e mungesës së energjisë elektrike vijuese të rregullt.

Neni 264

Nuk është e lejuar vendosja e agregatëve në trotualet e këmbësorëve ku pengohet qarkullimi i lirë i këmbësorëve ose karrocave për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 265

Alternativë për vendosje të agregatëve është: oborri, ara, objekti tjetër i pashfrytëzuar, garazhi, hapsira e lirë publike.

Neni 266

Në qoftë se nuk ekziston asnjë lokacion sipas nenit paraprak atëherë agregati mund të vendoset në qoshin ose skajin e trotuarit ku më së paku pengon, qarkullimin e lirë të këmbësorëve.

Neni 267

Për vendosje, të agregatëve të ashtuquajtur static, të cilët kanë fuqi më tepër se 5 kw , në hapsirat publike, trotuar të zgjeruar, qoshe të ndryshme, kthina, nën ballkone, bodrume e vende të tjera publike, nevojitet leje nga organi kompetent i administratës komunale.

Neni 268

Kabloja kryesore e agregatit që nevojitet për bartje të energjisë elektrike duhet të sigurohet nga fëmijët dhe kalimtarët, ndërkaq përgjegjësinë për rrezikshmërinë dhe fatkeqësinë eventuale, e bartë pronari ose shfrytëzuesi i agregatit.

Neni 269

Agregati duhet të sigurohet nga pronari ose shfrytëzuesi që të mos rrjedhë vajra gjatë punës së tij në tokë ose sipërfaqe tjetër të shtruar ose të ndodhë derdhja gjatë mbushjes me derivate.

Neni 270

Është i ndaluar përdorimi i agregatëve në vendet publike ose në vendbanim, të cilët me zhurmën që e krijojnë gjatë punës së tyre e tejkalojnë normën e paraparë për decibel dhe pengojnë qytetarët përrreth.

26. NDALESAT DHE GJOBAT

Neni 271

Me qëllim të mbajtjes të rregullit, dhe rendit shtëpiak të përgjithshëm si dhe mbajtjes së pastërtisë dhe të higjienës publike, janë paraparë ndalesat dhe gjobat.

Neni 272

Ndalohet shfrytëzimi i sipërfaqeve publike para lokaleve afariste, trotuar, rrugë ose hapësirë publike për shitjen, ekspozimin, ose vendosjen e përkohshme ose të përhershme të mallërave ose ambalazhit. Shfrytëzimi i sipërfaqeve duhet të bëhet në përputhje me vendimet e Kuvendit Komunal.

Neni 273

Ndalohet shfrytëzimi ose përvetësimi, pa leje paraprake, nga pronari ose organi kompetent i dheut, gurëve, druve, zhavorrit, mineraleve, burimeve të ujërave, thëngjillit, të pasurive të tjera nëntokësore ose mbitokësore, të cilat nuk janë pronë e tij. Gjoha, për personin juridik 50 - 500 €, për personin fizik 25 - 250 €.

Neni 274

Ndalohet dëmtimi, shkatërrimi, gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja etj. e objekteve me interes të përgjithshëm, siç janë: kabina telefoni, ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit, burimet ujore, lumenjt, objektet e parqeve, sportive dhe të rekreacionit, të shkollave, foshnjoreve, stacioneve, objektet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike si dhe objekte të tjera publike. Gjoha, për personin juridik 50 - 500 €, për personin fizik 15 - 150 €.

Neni 275

Ndalohet ndezja e zjarreve dhe hudhja e mbeturinave të posandezura të zjarrit nëpër sipërfaqe të hapura ku mund të shkaktohen dëme shumë të mëdha me anë të zjarrit, përveç në rastet e caktuara, në lokacionet e caktuara, dhe me lejen ose mbikqyrjen e njësisë të zjarrfikësve. Gjoha, për personin juridik 50 - 500 €, për personin fizik 25 - 200 €.

Neni 276

276.1 Për shkelje të dispozitave të kësaj rregullore nga personat juridik, gjobiten:

1. Për shkelje të neneve 62-68, 122, 128, 130-133, 137-144, 193, 202, 203, 207-209, 216, 253, 254 dhe 264-270 të kësaj rregullore, personat juridik gjobiten nga 25 - 200 Euro;
2. Për shkeljen e neneve 44, 49, 71-74, 78, 80, 82, 84, 100, 109, 113, 115-117, 127, 134-136, 157-162, 183-187, 205, 219-227, 230-244, 249-251 dhe 257-261, gjoha është nga 35 - 400 Euro;
3. Për shkeljen e neneve 20-26, 39, 42, 43, 46, 58, 61, 87-94, 97, 101, 106, 121, 123, 146, 152, 165-176, 181, 189-192, 197-199 dhe 256 gjoha është nga 50 - 500 Euro, ndërsa
4. Për shkeljen e neneve 86, 95 dhe 96 gjoha është nga 200-2000 Euro.

276.2 Për shkelje të dispozitave të kësaj rregullore nga personat fizik, gjobiten:

1. Për shkeljen e neneve 27-29, 42, 44, 62-68, 72,77, 80, 82, 84, 100, 109, 110, 113, 115-117, 122, 131-133, 141-144, 157-161, 183-187, 193, 202, 203, 207-209, 216, 219-227, 251, 253, 254, 257-261 dhe 264-270 gjoha është nga 10 - 100 Euro;
2. Për shkelje të neneve 21-26, 39, 46, 49, 58, 87-94, 97, 101, 121,123, 134-136, 146, 147, 152, 165-176, 181, 189-192, 199, 230-244, 249 dhe 256 gjoha është nga 25 - 250 Euro, ndërsa
3. Për shkelje të neneve 86, 95, 96 gjoha është nga 50 - 500 Euro.

276.3 Për dallim nga gjobat dhe denimet, për personat juridik dhe fizik, të cilën kudesen më së mirë për mirëmbajtjen e hapsirave publike ku jetojnë apo ushtrojnë veprimtarinë, komuna do të ndanë mirënjohje dhe cmime të vecanta.

Neni 277

Nuk është i lejuar, përdorimi, përhapja, ose propagandimi i urrejtjes, fyerjeve, nënçmimit, poshtërimit, sharjeve, përdhosjes ose dëmtimit moral apo material të objekteve përkujtimore dhe publike, të personave, të grupeve të njerëzve pa dallime racore, fetare, etnike, gjinore, gjuhësore. Gjoha, për personin juridik 100 - 1000 €, për personin fizik 50 - 500 €.

27. DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 278

Përveç gjobës, të paraparë me këtë rregullore, personat juridikë dhe fizikë, si shkaktues të dëmit, në rastet e parapara me rregullore, janë të obliguar që të bëjnë sanimin e gjendjes, respektivisht kthimin në gjendjen e mëparshme. Nëse personi juridik ose fizik nuk e sanon gjendjen, komuna do të kryejë punën me kompani tjetër ndërkaq, që shpenzimet do t'i bartë shkaktuesi i dëmit.

Neni 279

Kundërvajtjet, sipas kësaj rregulloreje, të cilat i shkaktojnë personat e mitur ose ata me aftësi të kufizuara mendore do të përgjigjet prindi, përkatsishtë kujdestari ose personi që përkujdeset për ta.

Neni 280

Është obligim i çdo qytetari të komunës së Kaçanikut që të respektojë rregullat e kësaj rregulloreje, që me punën dhe sjelljet e tij të mos bie në kundërshtim me rregullat e kësaj rregulloreje.

Neni 281

Zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bëjnë organet e administratës komunale sipas veprimtarive dhe punëve të tyre përkatëse ndërsa mbikqyrjen, mbi shkeljen e rregullave të kësaj rregulloreje, e kryejnë Inspektorët Komunal sipas veprimtarive të tyre, secili në fushën e vet, si dhe Policia e Kosovës, Njësia në Kaçanik.

Neni 283

Në të gjitha rastet kur kjo Rregullore Komunale për Shërbime Publike bie në kundërshtim me ligjet në fuqi ose me aktet nënligjore të autoriteteve qendrore, do të zbatohet Ligji në fuqi, përkatësisht aktet nënligjore.

Neni 284

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të zëvendësohen rregullat dhe vendimet e deritanishme që bien në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 285

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës - MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen zyrtare të komunës.

Kryesues i Kuvendit
Xhelal Gashi
